



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Skenderaj/Srbica
Skupstina Opstine Skenderaj/Srbica
Municipality of Assambly

STATUTI

I

KOMUNËS SË SKENDERAJT

Më 27. 11. 2008

HYRJE

Duke rikujtuar të kaluarën historike kombëtare, si dhe aspiratat politike dhe kulturore të vendit tonë, me vizionin për perspektivën demokratike të shoqërisë dhe institucioneve të Kosovës, komuna duke ofruar barazi ligjore, paanshmëri dhe mos diskriminim për të gjithë qytetarët, si dhe transparencë ndaj mediave, duke marrë parasysh mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, mbrojtjen e pakicave kombëtare, mbrojtjen e të drejtave civile dhe politike, si dhe mbrojtjen e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, të qytetarëve të saj dhe në interes të popullatës së komunës, më qëllim të përmirësimit të shërbimeve komunale, shtimit të efikasitetit dhe mundësive të barabarta për të gjithë, komuna me përgjegjshmëri dhe përgjegjësi morale , ligjore dhe politike ushtron pushtetin në tërë territorin e saj

Në bazë të nenit 124 nën 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të fuqizuar me 15 qershor 2008, në bazë të nenit 12 pika, 12.2 nën a dhe 12.3 të Ligjit për

Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 të fuqizuar më 29 qershor 2008, Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e mbajtur me 27. 11.2008 miratoi :

STATUTIN E KOMUNËS SË SKENDERAJT

PJESA E I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i këtij Statuti është përcaktimi i rregullave për të drejtat, detyrat dhe detyrimet morale, ligjore dhe politike në Komunën e Skenderajt, duke synuar barazi të plotë para ligjit pa asnjë lloj diskriminimi, duke ofruar debatin e hapur publik dhe transparencën ndaj mediave.

Neni 2

Përkufizimet

Çdo herë kur në këtë Statut përdoren , termat në vijim kanë këto kuptime:

1. “Kushtetuta “ - është akti juridik më i lartë i Republikës së Kosovës .

2. "Ligji" - është akt juridik i cili duhet të jetë në pajtim me Kushtetutë.
3. "Statuti i komunës"- është akti ligjor më i lartë (kryesor) që e miraton Kuvendi i Komunës me 2/3 dhe në pajtim legjislationin e Qeverisë Qendrore që rregullon organizimin e brendshëm të komunës.
4. "Rregullore e punës" - është akt nën ligjor që miratohet nga Kuvendi i Komunës që parashikon rregullat e rendit dhe të mirësjelljes
5. "Rregullore komunale" - është akt nën ligjor që miratohet nga numri i kërkuar i anëtarëve të Kuvendit të Komunës që rregullon një lëmi të caktuar të kompetencave të tij;
6. "Vetëqeverisje lokale" - do të thotë drejta dhe aftësia e autoriteteve lokale të themeluara sipas këtij Statuti dhe Ligjit në kuadër të kufizimeve të tyre , që të rregullojnë dhe udhëhehin një pjesë substanciale të çështjeve publike nën përgjegjësitë e tyre dhe në interes të popullatës së komunës.
7. "Komunë" - do të thotë njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës e përbërë nga qytetarët e komuniteteve në Komunën e Skenderajt të përcaktuar me ligjin për kufijtë e komunave nr.03/L-041 të datës 20 shkurt 2008.
8. "Kuvendi i Komunës"- është organi më i lartë vendimmarrës (legjislativ) Komunës së Skenderajt që përbëhet prej 31 anëtarëve të zgjedhur.
9. "Kryetari/ja i/e komunës"- është organi më i lartë ekzekutiv i Komunës së Skenderajt që zgjedhet përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta.

10. “Anëtarë” - janë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Skenderajt.

11. “ Komunitet “ – do të thotë grup njerëzish që i përkasin një grupi të njejtë etnik , fetar, racor apo gjuhësor.

12 . “Votim i shumicës” – do të thotë votim për të cilin kërkohet miratimi i më shumë se gjysmës së anëtarëve të pranishëm dhe votim në mbledhjen në të cilin s shqyrtohet propozimi. Ky është një mekanizëm përmes të cilit duhet të meren vendimet e kuvendit të Komunës së Skenderajt.

13. “ Shumica prej dy të tretave (2/3) – do të thotë votimi që kërkon miratimin e 2/3 e të gjithë anëtarëve të kuvendit të komunës së Skenderajt.

PJESA E II – KOMUNA

Neni 3

3.1 Komuna e Skenderajt është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, e përbërë nga qytetarët në territorin e saj, të përcaktuar me ligj dhe me këtë statut , e cila ushtron tërë pushtetin , i cili nuk është i rezervuar shprehimisht për institucionet qendrore.

3.2 Të gjitha organet e Komunës së Skenderajt , kujdesen që qytetarët e saj ti gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë pa dallim race, etnie, ngjyre, gjinie gjuhe, religjioni, mendimi politik apo mendimi tjetër, prejardhje kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi tjetër me qëllim që ata të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në shërbimet komunale të të gjitha niveleve.

3.3 Komuna e Skenderajt i zbaton politikat dhe praktikrat e saj për të mbështetur bashkëjetesën dhe paqen ndërmjet qytetarëve të saj për të krijuar kushte të përshtatshme që u mundësojnë të gjitha komuniteteve për t'i shprehur , ruajtur, zhvilluar identitetet e tyre etnike, kulturore , fetare dhe gjuhësore.

3.4 Të gjitha autoritetet komunale të Skenderajt u përgjigjen qytetarëve në format

përcaktuara me ligj.

3.5 Qytetarët e Skenderajt, kanë të drejtë që të marrin pjesë në aktivitetet e komunës, si parashifet me ligj .

3.5 Komuna ka të drejtë të lidhë marrëveshje me fshatrat, lagjet apo vendbanimet brenda territorit të saj , për tu ofruar më afër shërbime qytetarëve, në pajtim me nenin 34 të ligjit për vetëqeverisjen lokale dhe të këtij statuti.

Neni 4

Statusi ligjor i komunës

4.1 Komuna është person juridik, ka kompetencë që:

- a) të padisë dhe mund të paditet në gjykata;
- b) të posedojë dhe të udhëheqë pasurinë;
- c) të jetë pronare apo bashkëpronare e ndonjë kompanie që është në interes të komunës në raport me qytetarët;
- d) të lidhë kontrata ;
- e) të punësojë stafin; dhe
- f) të angazhohet në aktivitetet tjera që janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësisë të saj.

Neni 5

Emri dhe kufijtë

Komuna e ka emrin Skenderaj dhe kufijtë e saj si janë përcaktuar me ligjin për kufijtë administrativ të komunave nr.03/L-041 dhe mund të ndryshohen vetëm në përputhje me këtë ligj.

Neni 6

Simbolet

6.1 Komuna ka të drejtë të përdorë simbolet e saj si: vulat, emblemën dhe flamurin

komunal.

6.2 Komuna përdorë vulën shenjën dhe emrin e komunës.

6.3 Simbolet e komunës miratohen dhe ndryshohen nga kuvendi i komunës në pajtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore të Republikës së Kosovës.

6.4 Simbolet e komunës mund të miratohen , apo të ndryshohen me dy të tretat (2/3) e votimit të anëtarëve të kuvendit të komunës , pas konsultimit publik gjithëpërfshirës.

Neni 7

Komuna e ka selinë në Skenderaj, rruga “18 Qershori”.

Neni 8

Emblema

8.1 Komuna e ka emblemën e vet.

8.2 Përmbajtja dhe përdorimi i emblemës është përcaktuar me vendim të posaçëm të kuvendit.

8.3 Asnjë person, fizik apo juridik, përveç komunës, nuk ka të drejtë të përdorë emblemën, ose simbolet tjera të komunës pa autorizim të shkruar, firmosur dhe vulosur nga kryetari i komunës.

Neni 9

Vulat e Komunës

9.1 Komuna ka vulën e rrumbullakët dhe vulën katrore të protokollit:

a) vula e rrumbullakët përmban:

1. rrethi i parë: Republika e Kosovës

2. rrethi i dytë: Komuna Skenderajt;
3. rrethi i tretë: Drejtoria përkatëse;
4. në mes të vulës është emblema e komunës së Skenderajt;

b) vula e protokolit ka formën e katërkëndëshit kënddrejtë dhe përmban:

1. Republika e Kosovës;
2. Komuna e Senderajt;
3. Drejtoria përkatëse;
4. Nr. _____ më _____.

9.2 Mënyra e mbajtjes dhe përdorimit të vulave të Komunës, përcaktohet me vendim të posaçëm të Kryetarit/Kryetares.

Neni 10

Festat e komunës

10.1 Komuna e Skenderajt e ka javën e festës së vet publike, me emrin: Java e “Adem Jasharit”. Kjo festë, festohet në shtatë (7) ditët e para të muajit Mars të çdo viti. Me 7 Mars të çdo viti është ditë pushimi për komunën e Skenderajt dhe nuk punohet.

10.2 Komuna ka ditën e festës së vet publike, me emrin: Dita e Çlirimit të Skenderajt. Kjo festë, festohet me “18 Qershor “ të çdo viti. Me “18 Qershor “të çdo viti është ditë pushimi për komunën e Skenderajt dhe nuk punohet.

10.3 Për nderë të Javës “Adem Jashari” si dhe për nderë të Ditës së Çlirimit të Skenderajt, Kryetari/Kryetarja i/e Komunës bashkë me anëtarët e Kuvendit të Komunës ,

me mysafirë dhe me qytetarët e komunës, në mënyrë të organizuar, përkujtojnë Dëshmorët e Kombit dhe viktimat e luftës, duke bërë homazhe dhe vendosur kurora me lule në Varrezat e Dëshmorëve, si dhe duke bërë vizita në Familjet e Dëshmorëve dhe të Veprimtarëve të shquar të Çështjes Kombëtare Shqiptare.

10.4 Me rastin e festave të përmendura në pikat 10.1 dhe 10.2, të këtij neni, Kuvendi për familjet e dëshmorëve, invalidët dhe veteranët e UÇK, duhet të japë shpërblime, dekorata ose mirënjohje.

10.5 Kuvendi mund të japë shpërblime, dekorata ose mirënjohje edhe për persona apo subjekte të tjerë.

10.6 Kuvendi me vendim të posaçëm, përcakton kushtet, mënyrën dhe vlerën e dhënies së shpërblimeve, dhuratave ose mirënjohjeve.

10.7 Për nderë të festave të cekura në pikat 10.1 dhe 10.2 të këtij neni, Kuvendi i Komunës, nën përkujdesjen e Kryetarit/res të/së Komunës, organizon aktivitete edukative, kulturore, sportive dhe manifestime të ndryshme shoqërore në përputhje me karakterin e festave.

10.8 Kryetari/a i/e komunës, në emër të komunës, organizon një pritje solemne, për miq dhe kolegë të cilët i fton për nderë të festave lokale, duke manifestuar synimet e tij për një shoqëri dhe qytet të hapur, si dhe duke u angazhuar për bashkëpunim të mirëfilltë me komunitat brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës.

PJESA E III– GJUHËT

Neni 11

11.1 Përdorimi i gjuhëve në komunë rregullohet në pajtim me ligjin në fuqi për përdorimin e gjuhëve.

11.2 Kuvendi i komunës miraton rregullore të detajuar për përdorimin e gjuhëve brenda territorit të saj.

11.3 Kuvendi siguron përfaqësim proporcional të komuniteteve pakicë në organet dhe shërbimet e komunës.

11.4 Shenjat zyrtare që tregojnë emrat e fshatrave, të vendbanimeve, të rrugëve dhe të vendeve të tjera publike, duhet të jenë të shkruara në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.

11.5 Në kufijtë dhe territorin e komunës, pjesëtarëve të komuniteteve pakicë u garantohet e drejta e deklaramit të lirë të identitetit etnik, kulturor dhe fetar.

11.6 Pjesëtarët e komunitetit pakicë kanë të drejtë të komunikojnë në gjuhën e tyre me të gjitha organet e komunës dhe me të gjithë nëpunësit civilë të komunës.

11.7 Mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të komiteteve të tij, dhe të gjitha tubimet publike mbahen në gjuhën shqipe me përkthim simultan në gjuhën serbe.

11.8 Të gjitha dokumentet zyrtare të komunës, shtypen në dy gjuhë : shqip dhe serbisht. si plotësim, të gjitha dokumentet zyrtare të lëshuara nga komuna, do të jenë në gjuhën e palës. Supozohet së gjuha e palës është ajo në të cilën, së pari ai/ajo i është drejtuar komunës.

11.9 Shenjat zyrtare që tregojnë emrat e fshatrave, rrugëve dhe vendeve të tjera publike janë në gjuhën shqipe dhe serbe.

11.10 Komunikimi me organet dhe institucionet komunale bëhet në gjuhën : shqipe dhe serbe. Gjuha turke gjuha boshnjake mund të përdorën sipas nevojë.

11.11 Kuvendi i Komunës përmes rregullores do të rregullojë çështjen e përdorimit të gjuhëve.

11.12 Në organet e shërbimit civil të Komunës së Skenderajt sigurohet përfaqësimi proporcional gjinor dhe të komunitetit pakicë.

PJESA IV – ORGANET E KOMUNËS

Neni 12

Organet e komunës janë kuvendi dhe kryetari:

Neni 13

Aktet e organeve komunale

Kuvendi i komunës dhe kryetari kanë të drejtë të miratojnë akte dhe të ndërmarrin masa për zbatimin e tyre brenda fushës së kompetencave të tyre .Të gjitha aktet komunale duhet të jenë në përputhje me sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës .

Neni 14

Aktet e kuvendit të komunës

14.1 Kuvendi i komunës mund të miratojë akte brenda fushës të kompetencave të tij.

14.2 Aktet e kuvendit të komunës vlejnë në territorin e komunës që ka miratuar aktin. Këto akte përfshijnë:

- a) statutin e komunës ;
- b) rregulloren e punës;
- c) rregulloret komunale ; dhe
- d) çdo akt tjetër të nevojshëm apo të duhur për funksionim efikas të komunës.

14.3 Statuti i komunës miratohet dhe mund të ndryshohet me më së paku dy të

tretat 2/3 së anëtarëve të kuvendit të komunës.

14.4 Rregullorja e punës miratohet dhe ndryshohet , kur të jetë e nevojshme , me votimin e shumicës së anëtarëve të kuvendit të komunës.

Neni 15

Aktet e kryetarit të komunës

Kryetari i komunës ka të drejtë të nxjerrë urdhëresa dhe vendime brenda fushës të kompetencave të tij .

Neni 16

Pasuria e komunës

16.1 Komuna ka të drejtë të posedojë dhe të udhëheqë me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme.

16.2 Komuna ka të drejtë të shes dhe të jap me qira pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme sipas ligjit, me përjashtim të shitjes së tokës e cila rregullohet me ligj të posaqëm.

16.3 Komuna mban dhe udhëheqë regjistrin e pronës së luajtshme dhe të paluajtshme që e ka në shfrytëzim dhe posedim.

16.4 Komuna e ka avokatin publik komunal për ta përfaqësuar dhe për t'i mbrojtur interesat e përgjithmeshe të saj në kontestet e ndryshme.

PJESA E V – PROCEDURAT E NDRYSHIMIT DHE TË PLOTËSIMIT TË STATUTIT TË KOMUNËS

Neni 17

17.1 Iniciativën për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të komunës mund ta ndërmer :

- a) Kryetari Komunës;
- b) Një e treta (1/3) e anëtarëve të Kuvendit të Komunës;

c) Me iniciativën e 10% qytetarëve me te drejtë vote në komunë

17.2 Propozimi për ndryshimin e statutit të komunës duhet të dërgohet te kuvendi i komunës për shqyrtim fillestar. Kuvendi i Komunës para shqyrtimit final duhet ta konsultojë publikun në lidhje me atë propozim.

17.3 Çdo propozim për ndryshimin e Statutit të Komunës duhet të miratohet në Kuvendin e Komunës.

17.4 Pas përfundimit të periudhës së konsultimit, kuvendi i komunës duhet të vendos se a do ta miratojë statutin me ndryshime, pas shqyrtimeve të të gjitha vërejtjeve të marra.

PJESA E VI – KOMPETENCA E KOMUNËS

Neni 18

18.1 Komuna ka kompetenca të plota dhe ekskluzive (të veçanta) , për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm në fushat që vijonë:

- a) zhvillim lokal ekonomik;
- b) planifikim urban dhe rural;
- c) shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin e ekonomisë;
- d) zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;
- e) mbrojtjen e mjedisit lokal;
- f) ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë , kanalizimin dhe drenazhin , trajtimin e ujrave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehjes lokale.
- g) përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale;

h) ofrimin e kushteve të arsimit publik parashkollor , fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative , punësimin , pagesën e pagave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit;

i) promovimin e të drejtave të njeriut;

j) ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor;

k) ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve tjera të mirëqenies sociale, si është përkujdesi për të rrezikuarit, strehimi familjar, përkujdesin fëmijor, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave të përkujdesjes, punësimin, pagesën e pagave dhe trainimin e profesionistëve të mirëqenies sociale;

l) banimin publik;

m) shëndetësinë publike;

n) licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin , aktivitetet kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin , tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë;

o) emërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike;

p) ofrimin dhe mirëmbajtjen parqeve dhe hapësirës publike;

q) turizmit;

r) aktivitetet kulturore dhe të lira;

s) çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre , apo që nuk i është përcaktuar një autoriteti tjetër.

Neni 19

Kompetencat e deleguara

19.1 Autoritetet qendrore të Republikës së Kosovës u delegojnë përgjegjësi komunave në pajtim me ligjin për kompetencat vijuese:

a) shënimet kadastrave;

b) regjistrimin civil;

- c) regjistrimin e votuesëve;
- d) regjistrimin e biznesit dhe licencimin;
- e) distribuimin e pagesave të ndihmës sociale (me përjashtim të pensioneve);
- f) mbrojtja e pyjeve që ndodhën në teritorin e komunës në kuadër të të autorizimeve të deleguara nga autoriteti qendror, duke përfshirë edhe dhënjen e licencave për prerjen e drunjve në bazë të rregullave të miratuara nga Qeveria – Ministria përkatëse.

19.2 Autoritet qendrorë në Republikën e Kosovës mund t'u delegojnë kompetenca shtesë komunave, nëse është e nevojshme , në pajtim me ligjin.

19.3 Kompetencat e deleguara duhet , në të gjitha rastet , të shoqërohen me financim të nevojshëm në përputhje me objektivat , standardet dhe kërkesat e pëcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

PJESA E VII – FINANCAT KOMUNALE

Neni 20

Parimet themelore të financave komunale

20.1 Komuna e ka buxhetin dhe financat e saj për financimin e kompetencave të saj.

20.2 Buxheti i komunës përbëhet prej të hyrave vetanake ; granteve nga Qeveria e Republikës së Kosovës; donacioneve dhe të hyrave të tjera.

20.3 Buxheti dhe financat komunale rregullohet me ligjin për financat lokale nr.03/L 049 të datës 13 mars 2008.

20.4 Kërkesat thelbore për menaxhimin publik financiar dhe përgjegjshmëria , të përcaktuara në legjislacionin qendror, zbatohen për të gjitha komunat.

Neni 21

Shërbimet komunale që ofrohen nga ndërmarrjet komunale

21.1 Në rastet ku shërbimet komunale ofrohen nga ndërmarrjet komunale, ato

ndërmarrje duhet t'ia dorëzojnë buxhetet e tyre kuvendit të komunës për miratim. Propozimet buxhetore duhet të përfshijnë strukturën e propozuar të tarifës për ofrimin e shërbimeve dhe duhet të dorëzohen para datës 15 nëntor të vitit të ardhshëm fiskal.

21.2 Në rastet kur një ndërmarrje ofron shërbime publike komunale për më shumë se një komunë , komunat themelojnë bord të përbashkët menaxhues për mbikëqyrje të aktiviteteve të ndërmarrjes.

Neni 22

Auditimi i brendshëm

22.1 Komuna ka obligim ligjor për të bërë auditim të brendshëm, së paku një herë në vit.

22.2 Komuna ka të drejtë për të themeluar një shërbim autonom të auditimit në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm të Republikës së Kosovës.

Neni 23

Auditimi i jashtëm

Autoriteti qendror autonom bën auditimin e jashtëm të çdo komune në baza vjetore , në pajtim me ligjin në zbatim të auditorit gjeneral të Republikës së Kosovës.

PJESAE VIII- BASHKPUNIMI BRENDA KOMUNAL DHE NDËRKOMUNAL

Neni 24

Bashkpunimi ndërmjet komunës dhe Republikës së Kosovës

Komuna ka të drejtë të bashkëpunojë dhe krijoj partneritet me komunat tjera të Republikës së Kosovës , brenda fushës së kompetencave të saj, për kryerjen e funksioneve me interes të përbashkët, në pajtim me parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen lokale dhe në pajtim me ligjin.

Neni 25

Partneritetet komunale

25.1 Përgjegjësitë komunale në fushën e kompetencave të saj vetanake dhe të zgjeruara , me përjashtim të atyre të shënuara në nenin 40.2 të ligjit për vetëqeverisjen lokale, mund të ushtrohen përmes partneriteteve komunale.

25.2 Aktivitetet e partneriteteve financohen përmes buxheteve komunale të komunave pjesëmarrëse .

25.3 Partneritetet komunale mund t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për jetësimin dhe ushtrimin e bashkëpunimit funksional përmes , themelimit të një organi vendimmarrës të përbër nga përfaqësuesit e emruar nga kuvendet e komunave pjesëmarrëse , punësimit dhe shkarkimit të personelit administrativ dhe këshillëdhënës dhe vendimeve mbi nevojat për financim dhe nevojave tjera operationale të partneritetit.

25.4 Vendimet për partneritet u nënshtrohen mbikëqyrjes së ligjshmërisë në pajtim me dispozitat e nenit 79 të ligjit për vetëqeverisjen lokale.

Neni 26

Të drejtat e komunave për të formuar asociacione

Për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të tyre të përbashkëta, komunat formojnë dhe marrin pjesë në asociacionet që funksionojnë , në pajtim me ligjin.

Neni 27

Asociacionet e komunave të Republikës së Kosovës

27.1 Komunat individuale mund t'u bashkohen asociacioneve përfaqësuese të organeve vetëqeverisëse lokale të Republikës së Kosovës.

27.2 Aktet inkorporuese dhe dokumentet financiare të asociacioneve të tilla të bëhen publike. Komunat pjesëmarrëse duhet ta bëjnë publik informacionin për aktivitetin e komunave të tilla si dhe kontributet e tyre buxhetore që u jepen asociacioneve .

27.3 Asociacionet e tilla mund t'u ofrojnë anëtarëve të tyre një numër shërbimesh, duke përfshirë trainimin, ngritjen e kapaciteteve , ndihmën teknike dhe hulumtimin në kompetencat komunale dhe rekomandimet politike , në pajtim me ligjin .

Neni 28

Asociacionet e komunave të Republikës së Kosovës mund të bashkëpunojnë me asociacionet ndërkombëtare të autoriteteve lokale.

PJESA IX- FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE

Neni 29

29.1 Komuna e Skenderajt është e përberë prej këtyre vendbanimeve , lagjeve urbane dhe fshatrave si në vijim :

Skenderaj është qenderë komunale (vendbanim).

Lagjet urbane të qytetit të Skenderajt janë:

Kompleksi Adem Jashari,

Klinë e Poshtme,

Lagja I - Iliria,

Lagja II - Dardania,

Lagja III - Saraji,

Lagja IV - Fidanishta,

Lagja V - Qameria

Lagja VI - Ulpiana

29.2. Fshatrat e Komunës së Skenderajt janë:

Baks

Bajë
Burojë
Çirez
Çitak
Çubrel
Klinë e Poshtme
Abri e Poshtme
Prekazi i Poshtëm
Kopiliq i Poshtëm
Dashec
Klinë e Epërme
Prekaz i Epërm
Kopiliq i Epërm
Izbicë
Klladërnice
Kostërc
Kotorr
Kozhicë
Krasaliq
Krasmiroc
Kryshec
Kuçicë
Llaushë
Leçinë
Likoc
Lubavec
Makërmal
Marinë
Mikushnicë
Murgë

Açarevë
Pemishtë
Plluzhinë
Polac
Prelloc
Radishevë
Rakinicë
Rezallë
Runik
Skenderaj
Klinë e Mesme
Syriganë
Ticë
Tërnac
Turiqec
Tushilë
Vitak
Vajnikë

29.3. Kuvendi i Komunës në aspektin administrativ, territorin e komunës e organizon në bashkësi:

Bashkësia e Skenderajt përfshinë :

Skenderajin

Klinën e Poshtme

Lagjën I - Iliria

Lagjën II - Dardania

Lagjën III - Saraj

Lagjën IV - Fidanishtë

Lagjën V - Qamëria

Lagjën VI - Ulpiana

29.4 Bashkësia e Llaushës përfshinë;

Llaushën

29.5 Bashkësia e Runikut ;

Runikun

Bajën

Çitakun

Kostërcin

Leqinën

Pemishtën

Radishevën

Syriganën

29.6. Bashkësia e Klladernicës përfshinë :

Klladërnice

Izbicën dhe

29.7 Bashkësia e Çubrelit përfshinë:

Çubrelin

Rakinicën

Vitakun

29.8. Bashkësia e Turiqecit përfshinë :

Turiqecin

Burojën

Kopiliqin e Epërm

Kopiliqin e Poshtëm

Vajnikë

29.9 Bashkësia e Rezallës përfshinë :

Rezallën

Makërmalin

Tushilën

29.10. Bashkësia e Likocit përfshinë :

Aqarevën

Likocin

Murgën

Abrinë e Poshtme

Plluzhinën

Ticën

29.11 Bashkësia e Polacit përfshinë :

Polacin

Kryshecin

Marinën

Dashecin

29.12 Bashkësia e Çirezit përfshinë :

Çirezit

Baksin

Kozhicën

Krasaliqin

Krasmirocin

Prelllocin

29.13 Bashkësia e Prekazit të Epërm përfshinë:

Prekazin e Epërm

Prekazin e Poshtëm

Lubovecin

Mikushnicën

29.14 Bashkësia e Klinës së Epërme përfshinë:

Klinën e Epërme

Klinën e Mesme

Kotorrin

Kuçicën

Ternacin

PJESA E X - KUVENDI I KOMUNËS

Neni 30

Kuvendi i Komunës

30.1 Kuvendi i komunës është organi më i lartë në komunë dhe zgjedhet në mënyrë të drejtë përdrejtë nga qytetarët në pajtim me ligjin për zgjedhjet lokale.

30.2 Të gjithë qytetrët e komunës mund të kandidohen në kuvendin e komunës, me kusht që ata t'i plotësojnë kushtet e parapara me ligjin për zgjedhjet lokale.

30.3 Mandati i çdo antari të kuvendit të komunës verifikohet nga komisioni për verifikimin e mandateve që themelohet nga kuvendi i komunës, para nënshkrimit të mandatit nga secili antarë.

30.4 Të gjithë antarët e kuvendit të komunës duhet ta nënshkruajnë betimin solemn si në vijim:

“ Beto hem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nderë, me besnikëri, pa

anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si antarë/e i/e kuvendit të Komunës së Skenderajt, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

30.5 Anëtarët e kuvendit të komunës ,të cilët nuk e nënshkruajnë betimin ose mandatin në pajtim me paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni brenda një muaji pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve pushojnë të jenë anëtarë.

Neni 31

Numri dhe zgjedhja e anëtarëve të kuvendit

31.1 Numri i anëtarëve në kuvendin e komunës duhet të jetë proporcional , varësisht numri i qytetarëve në komunë.

31.2 Komuna e Skenderajt i ka mbi 56.000 banorë dhe kuvendi i komunës përbëhet prej 31 anëtarëve.

31.3 Komuna e Skenderajt i ka 378 km sipërfaqe tokësore.

Neni 32

32.1 Mandati i anëtarëve të kuvendit të komunës është katër vite.

32.2 Anëtari i kuvendit të komunës pushon të jetë anëtarë:

- a) me rastin e përfundimit të mandatit të tij;
- b) nëse ai/ajo ndërron vendbanimin ku është zgjedhur ;
- c) nëse anëtari ia paraqet kryetarit të komunës dorëheqjen me shkrim nga posti i tij;
- d) nëse anëtari ka qenë i denuar për ndonjë vepër penale dhe i është lëshuar urdhëri për burgim gjashtë muaj ose më shumë muaj;
- e) nëse anëtari nuk merr pjesë tre (3) muaj rresht në mbledhjet e kuvendit të komunës pa arsye;
- f) nëse ligji në fuqi , apo ndonjë ligj tjetër i zbatueshëm skualifikon apo e konsideron të papërzgjedhshëm.

32.3 Anëtari i kuvendit të komunës në të njëjtën kohë nuk mund të jetë deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës .

Neni 33

Konfliktet e interesit për anëtarë të kuvendit të komunës

33.1 Anëtari i kuvendit të komunës apo anëtari i komitetit nuk mund të jetë pjesëmarrës në marrjen e vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me cilëndo çështje në të cilën ai/ajo , apo ndonjë anëtarë i afërt i familjes së tij /saj , ka interes personal apo material.

33.2 Çdo anëtar duhet t'i shfaqë të gjitha konfliktet e interesit që lindin në çdonjërin prej mbledhjeve në të cilën është prezent. Çdo anëtar mund të ofrojë informacione për interesat e anëtarit tjetër.

33.3 Para mbledhjes së parë të kuvendit të komunës , anëtarët e kuvendit duhet t'i regjistrojnë deklaratat e plota dhe të hapura rreth interesave të tyre financiare në një regjistër publik.

34.4 Statuti dhe rregullorja punës përcaktojnë masat për përjashtimin e anëtarëve nga procesi i marrjes së vendimeve dhe nga procedurat administrative, aty ku kanë konflikt të interesit.

Neni 34

Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të kuvendit të komunës

34.1 Të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës kanë të drejta dhe mundësi të barabarta të marrin pjesë plotësisht në punimet e kuvendit . Kuvendi i komunës siguron që këto të drejta dhe mundësi të parashikohen në Statutin dhe Rregulloren e tij të punës.

34.2 Anëtari i kuvendit të komunës ka të drejtë të kërkojë informacione lidhur me çështjet komunale nga kryetari, apo nga kryesuesi i komitetit . Kërkesa shqyrtohet në pajtim me procedurat që do të përcaktohen në statutin komunës dhe rregulloren e tij të punës.

34.3 Anëtari i kuvendit të komunës mund të dorëzojë vërejtje me shkrim, të cilat i bashkëngjiten procesverbalit.

34.4 Anëtari i kuvendit të komunës mund t'iu drejtohet të pranishmëve në cilindo komision të kuvendit të komunës , anëtar i të cilit nuk është, por nuk mund të votojë.

Ai/ajo mund t'i propozojë kryesuesit të komitetit që të diskutohet ndonjë çështje që është përgjegjësi e komitetit.

34.5 Anëtari i kuvendit të komunës mund të kërkojë nga kryetari informacione që janë të nevojshme për punën e tij si anëtar. Nëse nuk është i kënaqur me përgjigjen , ai/ajo mund ta ngrisin çështjen në kuvendin e komunës.

34.6 Anëtari i kuvendit të komunës lejohet të mungojë nga vendi i punës për periudha kohore që janë të domosdoshme për kryerjen e punëve të kuvendit .

34.7 Kuvendi i komunës në pajtim me Statutin dhe me udhëzimet e nxjerra nga qeveria qendrore mund t'iu ofrojë kompensim anëtarëve të kuvendit për punën e tyre në kuvendin e komunës.

34.7 Anëtarët e kuvendit të komunës detyrohen të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e kuvendit, të thirrura në mënyrë të duhur të komisionit ku ata janë anëtarë, përveç rasteve kur ekzistojnë arsye të justifikueshme për mungesën e tyre .

Neni 35

Funksionimi i kuvendit të komunës

35.1 Kuvendi i komunës funksionon në bazë të ligjit për vetëqeverisjen lokale, të Statutit dhe të akteve tjera nënligjore .

35.2 Kuvendi i komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për:

- a) statutin dhe rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin , ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
- b) miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- c) miratimin e çështjeve të tjera financiare , të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas statutit apo rregulloreve të punës;
- d) planin vjetor të punës dhe raportin vjetor të punës;
- e) themelimin e komisioneve të kërkuara sipas ligjit për vetëqeverisjen lokale;
- f) zgjedhjen e kryetarit dhe të zëvendëskryetarit të komunës ;
- g) niveli i tarifave dhe ngarkesave;

- h) krijimin dhe përdorimin e simboleve , dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- i) emërimin dhe riemërimin e rrugëve , rrugicave dhe vendeve të tjera publike ;
- j) arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale;
- k) marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të Republikës së Kosovës ;dhe
- l) përgjegjësi të tjera që kërkohen me ligj.

35.3 Për marrjen e vendimeve , kuvendi i komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komitetit të kuvendit të komunës , apo kryetarit të komunës. Kuvendi i komunës mund të tërëheqë delegimin në çdo kohë.

Neni 36

Kryesuesi i kuvendit të komunës

36.1 Kuvendi i komunës e zgjedh kryesuesin e kuvendit të komunës nga radhët e anëtarëve.

36.2 Kryesuesi i kuvendit të komunës zgjedhet për një mandat të njëjtë sikurse edhe anëtarët e kuvendit.

36.3 Votimi në të gjitha zgjedhjet për kryesues të kuvendit të komunës është me vota të fshehëta.

36.4 Për t'u zgjedhur në votimin e parë , kandidati duhet të marrë më shumë se gjysmën e

votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur.

36.5 Në rast se në votimin e parë asnjëri prej kandidatëve nuk e siguron shumicën e kërkuar, atëherë dy kandidatët me numër më të madh të votave shkojnë në votimin e dytë. Kandidati që merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit të zgjedhur do të zgjedhet kryesues i kuvendit të komunës.

Neni 37

Mbledhjet e kuvendit të komunës

37.1 Kryesuesi i kuvendit të komunës thërret dhe kryeson mbledhjet e kuvendit të komunës.

37.2 Kuvendi i komunës mban së paku dhjetë mbledhje në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen gjat gjashtë muajve të parë të vitit , siç përcaktohet me rregulloren e punës.

37.3 Të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim, ashtu siç kërkohet, shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Në njoftimin e tillë shkruhet:

- a) data e mbajtjes së mbledhjes ;
- b) koha e mbajtjes së mbledhjes;
- c) vendi i mbajtjes së mbledhjes;
- d) rendi i ditës për mbledhje; dhe
- e) materialet e mbledhjes.

36.4 Njoftimi dhe materilet e mbledhjes duhet të bëhen me ligjin për përdorimin e gjuhëve. I njëjti njoftim duhet t'i shpallet publikut.

36.5 Njoftimi nga paragrafi 3 dhe 4 të këtij neni duhet gjithëashtu t'i dërgohet Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale.

Neni 38

Mbledhjet e jashtëzakonshme të kuvendit të komunës

38.1 Mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendi të komunës caktohet me kërkesën e bërë me shkrim nga, më së paku , një e treta $1/3$ e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit të komunës, apo me kërkesë të kryetarit.

38.2 E drejta për të thirrur një mbledhje të jashtëzakonshme gjithashtu përfshinë të drejtën për caktimin e rendit të ditës për mbledhjen e caktuar.

38.3 Pikat e caktuara në rendin e ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme , nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes .

38.4 Mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit të komunës nuk mbahet nëse të gjithë

anëtarët e kuvendit të komunës dhe publiku nuk janë të njoftuar me shkrim, siç kërkohet me rregulloren e punës, së paku tri (3) ditë pune para ditës së mbajtjes së mbledhjes.

38.5 Procedurat e njëjta që kërkohen për njoftimin dhe çështje të tjera që zbatohen për mbledhjet e rregullta, gjithëashtu zbatohen edhe për mbledhjet e jashtëzakonshme.

38.6 Procedurat e lartpërmendura nuk zbatohen për mbledhjet që thirren për shkak të rrethanave urgjente.

Neni 39

Mbledhjet e hapura

39.1 Mbledhjet e kuvendit të komunës dhe komiteteve të tij janë të hapura për opinion.

Anëtarëve të publikut u lejohet pjesëmarrja në mbledhjet e kuvendit të komunës, ashtu siç është paraparë në rregulloren e punës.

39.2 Njoftimi për mbledhjen e hapur të kuvendit të komunës bëhet publik.

39.3 Kuvendi i komunës, apo komiteti, me votën e shumicës, mund të vendos për përjashtimin e opinionit nga e tërë mbledhja, apo nga një pjesë e saj, në rastet kur:

a) mendohet se mbajtja e një mbledhje të hapur mund të shpie deri të një çrregullim publik apo dhunë;

b) mbledhja e hapur kërkon të zbulojë informacione dhe dokumente, të cilat janë të klasifikuara si të besueshme sipas ligjit për qasjen në dokumentet zyrtare;

c) kërcnon të zbulojë informacione të ndieshme personale apo komerciale; dhe

d) informacione lidhur me procedurat gjyqësore të tanishme apo të ardhshme.

39.4 Në rastet e tilla, kuvendi i komunës njofton për vendimin e marrur.

39.5 Kuvendi i komunës mund të mbajë edhe mbledhje të mbyllura.

Neni 40

Kuorumi

40.1 Kuorumi për të gjitha mbledhjet e kuvendit të komunës dhe komiteteve të tij është së paku gjysma e numrit të anëtarëve të kuvendit të komunës.

40.2 Kuorumi duhet të verifikohet para se të fillojë punën kuvendi dhe para çdo vendimi të marrur.

Neni 41

Rendi i ditës

41.1 Rendi i ditës për mbledhjen e kuvendit të komunës caktohet nga kryesuesi i kuvendit të komunës në marrëveshje me kryetarin e komunës.

41.2 Anëtari i kuvendit të komunës mund të kërkojë shtimin e një pike në rendin e ditës gjatë mbledhjes së rregullt të kuvendit të komunës , nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rend të ditës është çështje urgjente me rëndësi publike.

41.3 Kërkesa e tillë mund të miratohet apo të refuzohet me votën e shumicës.

41.4 Rregullorja e punës së kuvendit të komunës parashef dispozita tjera për përgatitjen , miratimin dhe ndryshimin e rendit të ditës.

Neni 42

Votimi

42.1 Në të gjitha mbledhjet e kuvendit të komunës dhe komitetet e tij , çdo person, përfshirë edhe kryesuesin , ka nga një votë , por kryesuesi ka një votë shtesë nëse votimi është i barabartë për ose kundër një propozimi.

42.2 Nëse ndryshe nuk parashihet shprehimisht me ligjin për vetëqeverisjen lokale , vendimet e kuvendit të komunës miratohen me shumicën e anëtarëve që janë të pranishëm dhe votojnë.

42.3 Abstenimet shënohen me qëllim të themelimit të kuorumit, por nuk merren parasysh në rezultatet e votimit.

Neni 43

Procesverbali

Procesverbalet mbahen në pajtim me ligjin për përdorimin e gjuhëve nga të gjitha mbledhjet e kuvendit të komunës dhe komiteteve të tij dhe miratohen në mbledhjen e ardhshme.

Neni 44

Shpërndarja e kuvendit jo funksionues të komunës

44.1 Nëse kuvendi i komunës dështon në kryerjen e funksionit të detyrueshëm sipas standardeve të përcaktuara me ligj, ose nëse bëhet jo funksionues dhe kështu rrezikon ushtrimin e të drejtave themelore të qytetarëve, Ministria përgjegjëse për qeverisje lokale njofton komunën për deshtimin dhe kërkon që të ndërmerren masa të duhura në mënyrë që të sigurohet kryerje e qetë e funksionit komunal.

44.2 Kuvendi i komunës konsiderohet jo funksionues nëse:

- a) nuk e zgjedh kryesuesin, tridhjetë (30) ditë pas themelimit;
- b) nuk miraton statutin e saj brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh pas themelimit;
- c) nuk miraton buxhetin sipas afatit të paraparë me ligjin përkatës; dhe
- d) nuk mban mbledhje për një periudhë më të gjatë se gjashtë (6) muaj.

44.3 Ministria përgjegjëse për qeverisje lokale e njofton Qeverinë e Republikës së Kosovës për mos funksionimin e komunës. Qeveria mund ta shpërndaj kuvendin e komunës jofunksionues.

44.4 zgjedhjet e reja për kuvendin e komunës mbahen në pajtim me ligjin për zgjedhjet komunale.

Neni 45

Komitetet e përhershme

45.1 Kuvendi i komunës themelon komitetet : Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete si komitete të përhershme.

45.2 Kuvendi i komunës themelon komitete të tjera për të cilat konsideron se janë të nevojshme për kryerjen e përgjegjësive të tyre .

45.3 Nëse nuk parashifet ndryshe me ligj , komitetet reflektojnë përbërjen e kuvendi të komunës.

Neni 46

Komiteti për politikë e financa

46.1 Komiteti për politikë dhe financa kryesohet nga kryesuesi i kuvendit të komunës dhe përbërja e tij duhet të reflektojë përfaqësimin e entiteteve politike në kuvendin e komunës.

46.2 Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave , dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave , duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifrat dhe pagesat , planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjat vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në kuvendin e komunës.

Neni 47

Komiteti i komuniteteve

47.1 Komiteti për komunitete përfshinë në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e kuvendit të komunës , anëtarët tjerë janë përfaqësuesit e komuniteteve. Çdo komunitet që jeton në komunë përfaqësohet nga, së paku një përfaqësues në komitetin për komunitete. Përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë në komunë e përbëjnë shumicën e anëtarëve të komitetit të komuniteteve.

47.2 Komiteti i komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon kuvendit të komunës masat që duhet të ndërmiren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar , shprehur , mbrojtur dhe zhvilluar

identitetin e tyre etnik, kulturor , fetar dhe gjuhësor , si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

PJESA XI – UDHËHEQËSIA E KOMUNËS

Neni 48

Zgjedhja e kryetarit të komunës

48.1 Kryetari i komunës zgjedhet me zgjedhje të dretëpërdrejtë në pajtim me ligjin për zgjedhjet lokale.

48.2 Kryetari i komunës zgjedhet për një periudhë katër (4) vjeçare.

47.1 Mandati i kryetarit të komunës përfundon;

- a) kur ta kryejë mandatin e tij;
- b) nëse vdes;
- c) nëse jep dorëheqje;
- d) nëse ndërron vendbanimin në komunë tjetër;
- e) nëse nuk paraqitet në punë për më shumë se 1 muaj pa arsye;
- f) nëse shkarkohet nga detyra në pajtim me ligjin për vetëqeverisjen lokale;
- g) në rast të vendimit përfundimtar të gjyqit që e privon kryetarin e komunës nga cilësia juridike; dhe
- h) në rast të denimit për vepër penale më një urdhër për burgim për gjashtë (6) muaj apo më tepër.

Neni 49

Betimi

49.1 Me rastin e zgjedhjes , kryetari e jep betimin ose deklaratën solemne para anëtarëve të kuvendit të komunës. Teksti i betimit është si në vijim:

“Beto hem (ose deklaroj solemnisht) që do t'i kryej detyrat e mia dhe do t'i ushtroj kompetencat e mia si kryetar i komunës së Skenderajt me nderë, besnikëri, në mënyrë të

paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që t'i siguroj kushte për një jetë të qetë për të gjithë.”

49.2 Kryetari që dështon ta japë betimin brenda një (1) muaji nga certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve e humb mandatin.

Neni 50

50.1 kryetari i komunës i zbaton përgjegjësitë në vijim:

- a) përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj;
- b) udhëheqë ekzekutivin e komunës dhe administratën e saj dhe e mbikëqyrë administrimin financiar të komunës;
- c) ushtron të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite (të përcaktuar) kuvendit të komunës apo komiteteve të tij;
- d) ekzekuton aktet e kuvendit të komunës;
- e) emron apo shkarkon nënkryetarin e tij /saj;
- f) emron dhe shkarkon anëtarët e tij të cilët i ndihmojnë atij në kryerjen e detyrave ;
- g) organizon punën dhe drejton politikën e komunës ;
- h) propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në kuvendin e komunës;
- i) propozon zhvillimin komunal, planet rregullative dhe investuese , propozon buxhetin vjetor për miratim në kuvendin e komunës dhe e ekzekuton buxhetin e miratuar;
- j) raporton para kuvendit të komunës për situatën ekonomiko – financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës;
- k) mund të kërkojë që kuvendi i komunës ta shqyrtojë një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsideron se akti cënon legjislacionin në zbatim apo interesin e komuniteteve; dhe
- l) aktivitete tjera që i caktohen me këtë statut.

Neni 51

Konflikti i interesit

51.1 Menjëherë pas zgjedhjes së tij, kryetari i komunës ndërpret çdo kontratë apo lidhje që ka , e cila mund ta vë në pikëpyetje aftësinë e tij për kryerjen e përgjegjësive të tij në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.

51.2 Kryetari i komunës përjashtohet nga procedurat vendimmarrëse dhe administrative që kanë të bëjnë me ndonjë çështje , në të cilën ai , apo ndonjë anëtarë i afërm i familjes së tij , ka interes personal apo financiar.

51.3 Nga kryetari i komunës kërkohet t'i paraqesë konfliktet e interesit sapo të paraqiten ato.

51.4 Kryetari i komunës mundet vullnetarisht ta përjashtojë veten nga vendimmarrja dhe procedurat administrative , nëse konsideron që mund të ketë konflikt të interesit. Kryetari shënon çdo ndryshim në gjendjen financiare menjëherë pasi që ai të paraqitet.

51.5 Stauti parasheh masat që duhet të ndërmiren për të përjashtuar kryetarin nga procedurat e vendimarrjes dhe administrative në rastet kur ka konflikt të interesit.

Neni 52

Nënkryetari i komunës

52.1 Në komunë, kryetari i komunës ka një nënkryetar .

52.2 Nënkryetari emërohet nga kryetari për të njëjtin mandat dhe shkarkohet nga kryetari.

52.3 Me kërkesë të kryetarit, nënkryetari i ndihmon kryetarit në ushtrimin e funksioneve ekzekutive të përditëshme dhe vepron në emër të kryetarit në mungesë të tij.

52.4 Kur posti i nënkryetarit mbetet i lirë, kryetari emëron nënkryetarin e ri , jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas paraqitjes së postit të lirë.

52.5 Neni (51) për konfliktin e interesit të kryetarit zbatohet edhe për nënkryetarin e komunës.

Neni 53

Drejtorët komunal

53.1 Administrata komunale organizohet në drejtori.

53.2 Çdo drejtori komunale udhëheqet nga një drejtor i cili emërohet dhe hkarkohet nga kryetari.

53.3 Drejtorët udhëheqin drejtoritë e tyre në përputhje me udhëzimet strategjike dhe politike të kryetarit dhe në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

53.4 Drejtorët i raportojnë rregullisht kryetarit për çështjet që janë nën përgjegjësitë e tyre dhe i ofrojnë atij të gjitha informatat dhe raportet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes.

Neni 54

Konflikti i interesit për drejtorët

54.1 Drejtorët përjashtohen nga marrja e vendimeve dhe nga procedurat administrative që kanë të bëjnë me çfarëdo çështje për të cilën ai apo ndonjë anëtar i ngushtë i familjes së tij ka ndonjë interes personal financiar.

54.2 Nga drejtorët kërkohet që të paraqesin me shkrim çdo konflikt të interesit menjëherë pasi të shfaqen.

54.3 Statuti dhe rregullorja e punës përfshijnë masat të cilat merren për të përjashtuar drejtorët nga vendimmarrja dhe procedurat administrative ku ata kanë konflikt interesash.

Neni 55

Shkarkimi

55.1 Kryetari i komunës mund të suspendohet me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës brenda afatit prej 30 ditëve , nëse kryetari i komunës ka cenuar Kushtetutën dhe ligjet në fuqi.

55.2 Nëse konsideron se janë plotësuar kushtet për suspendimin nga detyra e kryetarit të komunës, Ministria përgjegjëse për pushtetin lokal do t'i rekomandojë Qeverisë së Republikës së Kosovës brenda (30) ditëve mund të suspendojë me vendim kryetarin e komunës dhe t'i dorëzojë lëndën në Gjykatën Kushtetuese.

55.3 Nëse Gjykata Kushtetuese e përkrah vendimin , qeveria mund të shkarkojë nga detyra kryetarin.

PJESA E XII – ADMINISTRATA KOMUNALE

Neni 56

Shërbimi civil komunal

56.1 Shërbimi civil komunal përfshinë të gjithë personat e punësuar nga autoriteti komunal, paga e të cilëve paguhet nga buxheti i Republikës së Kosovës , përveç :

- a) kryetarit, nënkryetarit dhe drejtorëve të drejtorive komunale;
- b) kryesuesit , zëvendëskryesuesit dhe të gjithë anëtarëve të kuvendit të komunës.

56.2 Drejtorët komunal, drejtorët e institucioneve dhe ndërmarrjeve nën autoritetin e komunës dhe nëpunësit civil të administratës së komunës nuk mund të jenë anëtarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës apo kuvendit të komunës ku ata punojnë.

56.3 Zgjedhjet për kuvendin e komunës nuk përbëjnë shkak për rishqyrtimin e emërimeve të shërbyesëve civil.

Neni 57

Administrata komunale dhe udhëheqësi i personelit

57.1 Administrata komunale organizohet në drejtori. Çdo drejtori komunale udhëheqet nga drejtori. Drejtorët komunal emërohen dhe shkarkohen nga kryetari.

57.3 Administrata komunale e ka udhëheqësin e personelit .

57.4 Kryetari shpallë, rekruton dhe largon udhëheqësin e personelit në pajtim me ligjin e aplikoshëm të shërbimit civil.

57.8 Nëse posti i udhëheqësit të personelit mbetet i zbrazët , kryetari i komunës emëron një anëtar të lartë të shërbimit civil në cilësinë e kryesuesit të udhëheqësit të personelit .

57.9 Brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh, kryetari rekruton udhëheqësin e personelit në pajtim me nenin 56.2 të këtij statuti.

Neni 58

Konflikii interesit

Nëpunësi i administratës komunale përjashtohet nga vendimmarrja dhe procedurat administrative lidhur më ndonjë çështje në të cilën ai/ajo ose ndonjë anëtar i afërm i familjes së tij , ka interes personal apo financiar.

PJESA E XIII – DREJTORITË KOMUNALE

Neni 59

59.1 Me këtë statut themelohen 7 drejtori komunale. Drejtoritë e komunës së Skenderajt janë:

1. Drejtoria për administratë;
2. Drejtoria për financa, ekonomi dhe zhvillim;
3. Drejtoria për gjeodezi, kadastër dhe pronësi;
4. Drejtoria për urbanizëm , ndërtim dhe mbrojtje të ambientit;
5. Drejtoria për arsim dhe kulturë;
6. Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenje sociale dhe
7. Drejtoria për shërbime publike.

59.2 Komuna sipas nevojës dhe mundësive buxhetore mund të themelojë edhe drejtori të tjera.

Neni 60

Drejtoria për Administratë

60.1 Drejtoria për administratë për të funksionuar në mënyrë efikase dhe profesionale do të ketë këto forma të organizimit të punës:

- a) sektorin e ofiçarisë;
- b) zyrën pritëse dhe arkivin e komunës;
- c) njësinë e autoparkut të veturave zyrtare të komunës ;
- d) njësinë për të drejtat e njeriut;
- e) zyrën e komunitetit;
- f) zyrën e prokurimit;
- g) shërbimin profesional për punët e kuvendit;
- h) shërbimi profesional për punët e kryetarit
- i) zyrtarin ligjor komunal;
- j) zyrtarin për integritet evropian; dhe
- k) zyrtarin për kthim

Neni 61

Drejtoria për financa, ekonomi dhe zhvillim

Bazuar në ligjin për veteqeverisjen lokale të komunave të Republikës së Kosovës ,Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim ka drejtorin e emëruar nga kryetari i komunës, i cili/cila ka përgjegjësi për udhëheqjen dhe menaxhimin e drejtorisë,i raporton kryetarit rregullisht për çështjet që janë në kompetencë të tij apo të saj.

a) Buxheti dhe Financa

Përgatitja e rregulloreve komunale për Komitetin Për Politikë dhe Financa nga fushëveprimi i financave;

Udhëheqja e çështjeve financiare të Komunës;

Ndihmon kryetarin e komunës dhe Komitetin për Politikë dhe Financa në përgatitjen e Buxhetit vjetor të Komunës para paraqitjes së tij nga kryetari i komunës për miratim;

Përgjegjësia për mbajtjen e të gjitha llogarive në Komunë,për një proces transparent buxhetor, me një shkallë të lartë të mbikqyrjes së drejtorive;

Përgjegjësinë e përgatitjes së procedurave dhe raporteve të kontabilitetit, i kryen të gjitha pagesat pas aprovimit nga drejtoria përkatëse dhe kryetari i Komunës.Jep komente mbi çështjet buxhetore, para se të merret vendimi në Kuvendin e Komunës;

Mbajtjen e të gjitha llogarive në Komunë, integrimin e sistemit Free Balance për mbajtjen e llogarive në proceset komunale të menaxhimit financiar. Menaxhimin e fondeve komunale;

U jep këshilla Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komiteteve tjera, mbi të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me buxhetin e Komunës;

Është përgjegjëse për mbajtjen e llogarive dhe raporteve vjetore financiare;

Përgjegjës edhe për menaxhimin e thesarit;

Mbikqyrjen dhe monitorimin e sistemeve dhe procedurave për ekzekutimin e buxhetit;

b) Ekonomi dhe Zhvillim

Brenda kompetencave të veta, komuna do të kërkojë krijimin e një kornize të përshtatshme për ekonomi të qëndrueshme lokale.

Në kontest të planit për zhvillim ekonomik komuna mund të caktojë prioritetet për investim në komunë, si dhe t'i koordinojë ato me MEF

Komuna mund të promovojë industri zejtare dhe vendore në territorin e saj dhe të sigurojë korniza për zhvillim të industrive zejtare, në pajtim me Ligjin e Kuvendit të Kosovës 2004/44 mbi zejtarinë.

Gjatë dy muajve të parë të çdo viti komuna do t'i bënë publike shumat e parapara buxhetore për secilën kompetencë, ndërsa brenda 9 muajve pas fundit të çdo viti komuna do t'i bënë publike shumat e shpenzimeve për secilën fushë të kompetencës.

Në pajtim me Ligjin 2002/5 mbi përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, komuna mund të kërkojë caktimin e hapësirave për biznese në territorin e vet nëse lokacioni gjendet në një tokë të ndërmarrjes sociale të pashfrytëzuar, atëherë komuna mund t'i paraqes kërkesë Qeverisë Qendrore për të kërkuar që menaxhimi i tokës t'i bartet komunës.

Komuna duhet ta promovojë turizmin brenda territorit të vet në pajtueshmëri me ligjin në fuqi.

Hartimin e politikës së zhvillimit ekonomik, propozimi i marrjes së masave për zhvillimin ekonomik të komunës;

Hartimi i planit global strategjik të zhvillimit ekonomik të komunës duke përfshirë të gjithë sektorët e ekonomisë si në aspektin afatshkurtër ashtu edhe në aspektin afatgjatë; Hartimi i programeve ideore duke i specifikuar veprimtaritë ekonomike me qëllim të zhvillimit të sektorëve prioritar , kontaktet me institucionet vendore financiare si me bankat komerciale e institucionet financiare ndërkombëtare për t,u pajisur me informacione të mjaftueshme, e të sakta lidhur me kushtet e kreditimit (financimit) të bizneseve të ndryshme;

Dhënja e këshillave për afristët e ndryshëm për mundësinë e investimeve, angazhimit të kapitalit të tyre në veprimtaritë prodhuese e profitabile por edhe përspektive;

Organizimi dhe menaxhimi i panairëve tradicionale të mallrave e të ndryshme të prodhuara nga bizneset;

Ndihma në organizimin e konferencave ndërkombëtare për mundësinë dhe perspektivën e zhvillimit ekonomik të komunës;

Bashkëpunimi me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë rreth mundësisë së koordinimit të punëve e të aktiviteteve për zhvillimin ekonomik të komunës; bashkëveprimi me ndërkombëtarët për koordinimin e punëve rreth zhvillimit ekonomik të komunës; Dhënja e informatave e raporteve të punës, për periudha të caktuara për nevojat e institucioneve komunale; Dhënja e lejes së punës, inkasimi i pagesave të lejeve të punës, evidentimi i ndryshimeve në lejet e punës dhe certifikatave të biznesit, dhënja e formularëve për aplikimin dhe njoftimin paraprak për bizneset, dhënja e informatave profesionale dhe raporteve për drejtorinë dhe institucionet e komunës.

Informata mbi rezultatet afariste, prodhimit, eksportit – importit, raport mbi shkallën e punësimit si dhe shfrytëzimit të kapaciteteve , grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave mbi vëllimin fizik të prodhimit si dhe shënime të tjera në vazhdimësinë e ecurive dhe dinamikës ekonomike për periudhën 3 mujore, 6 mujore dhe në fund të vitit informtat mbi treguesit financiar afarist për periudhën 6 mujore;

c) Bujqësi dhe pylltari

Me ligjin nr.02/l – 26 për tokën bujqësore përcaktohet shfrytëzimi, mbrojtja rregullimi dhe qirashënja e tokës bujqësore, me qëllim të ruajtjes dhe mirëmbajtjes së potencialit bujqësor në mënyrë të përhershme, duke u bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Bazuar në ligjin nr.02/l-26 për tokën bujqësore neni 8 përcakton mbajtjen e evidencës për tokat bujqësore.

Personat juridik që merren më veprimtari bujqësore janë të obliguar të mbajnë evidencën për tokën bujqësore të cilën e shfrytëzojnë apo e posedojnë.

Organi komunal kompetent për bujqësi është i obliguar të mbajë evidencë për tokën e pa punuar, tokën e dhënë në shfrytëzim, dhe evidencën për tokën të cilës i është ndërruar destinimi i shfrytëzimit.

Organi kompetent komunal këto të dhëna ia dërgon Ministrisë sipas kërkesës së saj.

Bazuar në ligjin nr.02/l -26 për tokën bujqësore neni 12.2. thekson se organi komunal kompetent për bujqësi është i detyruar të sigurojë se toka bujqësore do të shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore.

Bazuar në ligjin nr.02/l-26 për tokën bujqësore neni 17.1. (b) dhe 13.2. të këtij ligji, toka e cila nuk ka karakter të përhershëm, i kthehet destinimit të parë apo destinimit tjetër, përkatësisht aftësohet për prodhimtari bujqësore sipas projektit për ri-kultivim. Pëlqimin në projektin për ri-kultivim e jep organi kompetent komunal për bujqësi.

Bazuar në ligjin mbi pyjet nr.2003/03 , neni 4 për gjendjen e tokës thotë organi administrativ komunal që merret me çështjet e pronësisë mund të vendosë mbi shtrirjen e kufijve të pyjeve dhe tokave pyjore përbrenda komunës.

Të sigurojë riparimin e pajisjeve bujqësore, makinave, traktorëve, kombajnave për korrije.

Të ofrojë repromaterial për mbjellje bujqve që të ju mundësojë atyre të rifillojnë punën përmes bankave komerciale, të hulumtojë format e kreditimit, për stimulimin dhe avancimin e prodhimtarisë blegtorale.

Të koordinojë punën dhe bashkëveprojë me OJQ-të që përkrahin aktivitetet bujqësore.

Të lidhë dhe bashkëpunojë ngushtë me kooperativat bujqësore. Të ofrojë trajnime në lëminë e bujqësisë.

Të ofrojë shërbime veterinërve dhe të përkujdeset për mbrojtjen e shëndetit dhe

parandalimin e sëmundjeve të kafshëve shtëpiake.

Të ofrojë shërbim kujdestarie ndaj qenve endacak.

Të ofrojë shërbim për mbrojtje të shëndeti publik të popullatës përmes kontrollit të produkteve me origjinë bimore shtazore.

Të koordinojë dhe mbikëqyrë aktivitetet e gjuetisë.

Të identifikojë tokën bujqësore në pronësi të komunës dhe shtetit. Përgjegjës për firmat bujqësore dhe ndërmarrjet nën autoritetin e Komunës, përfshirë këtu edhe aktivitetin blegtoral.

Mbrojtjen e tokës prej thatësirave dhe sëmundjeve furnizimin me ujë dhe ujitjen e sipërfaqeve të tokave të punueshme.

Mbrojtjen e resurseve natyrore duke përfshirë pyjet, rërët, dhe aktivitetet për thyrjen e gurëve, për të gjitha këto kategori të jep pëlqimin për shfrytëzim dhe ta mbikëqyrë shfrytëzimet.

Të bashkëpunojë ngushtë me AKM, me rastin e transferimit të pronës së kombinateve dhe kooperativave bujqësore.

Komuna siguron ndihmë të rëndësishme bujqëve në organizimin e tyre, dhënien e këshillave profesionale, ofrimin e donatorëve dhe investitorëve.

Ofrimi i mbështetjes së duhur për qëndrimin e njerzëve në fshatra me qëllim të nxitjes së ruajtjes së tokave bujqësore.

Përmirësimi i sasisë dhe cilësisë së prodhimeve bujqësore, ofrimi i donacioneve dhe investimeve për zhvillimin e zonave rurale.

Ruajtjen e tokës bujqësore nga ndërrimi i destinacionit të sajë dhe trajtimin adekuat të tokës.

Përkrahja e politikave zhvillimore për bujqësi.

Për të funksionuar Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, do të ketë (5) sektor :

1. sektori për buxhet dhe financa, analiza dhe raporte,
2. sektori për të hyra dhe leje të punës,
3. sektori për tatim në pronë,
4. sektori për ekonomi dhe zhvillim,
5. sektori për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural.

Neni 62

Drejtoria për gjeodezi , kadastrë dhe pronësi

Zyra e Kadastrale Komunale, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së vet, në pajtim me ligjin nr.2003/25 për kadastrën, i nënshtrohet autoritetit të Agjencisë, Udhëzimeve Administrative dhe akteve tjera nënligjore të nxjerra nga Ministria e Shërbimeve Publike.

Me ligjin nr.2003/25 për kadastrën konstituohet kadastrë, i cili është regjistër zyrtar për regjistrimin e parcelave kadastrale, ndërtesave, pjesëve të ndërtesave, përçuesve dhe objekteve nëntokësore në Kosovë.

Në regjistrin zyrtar regjistrohen të dhënat e tokës, ndërtesat, pjesëve të ndërtesave, hartave kadastrale dhe tërsia e formularëve të kadastrës, për qëllime: të sistemit informativ të tokës, administrative, juridike, ekonomike dhe shkencore.

Në bazë të nenit 7.2. të ligjit mbi kadastrat secila komunë është e ndarë në zona Kadastrale. Njësia themelore i përket një zone të caktuar Kadastrale. Agjencia Kadastrale e Kosovës mund të vendosë të ndryshojë ndarjen në zona kadastrave, pas konsultimeve me Kuvendin e Komunës në fjalë. Kjo çështje do të rregullohet me një Udhëzim Administrativ në mënyrë më të detajuar. Nëse kufiri në mes dy komunave ndryshohet, atëherë edhe kufiri i Zonave Kadastrale në ato pjesë të ndryshohen në pajtim me të.

Në bazë të nenit 7.3. të ligjit mbi kadastrat çdo njësi themelore në Kadastrë do të ketë një shënim të caktuar. Shënimi do të përbëhet nga emri dhe numri i Zonës Kadstrale.

Në bazë të Urdhëresës administrative 2004/08 MSHP për zbatimin e ligjit nr.2003/25 për kadastrën, Zyrat Komunale të Kadastrës do të regjistrojnë dhe mirëmbajnë kadastrën e palujtshmërive me të gjitha shënimet dhe do të lëshojë dokumentet nga evidenca e saj për palët e interesuara sipas standardeve që përcaktohen nga Agjencia e Kadastrave të Kosovës.

Në bazë të urdhëresës administrative 2004/08 MSHP, ZKK kontrollon dhe korrigjon operativin kadastral dhe hartat e kadastrave, kryen punën në terren, bënë vendosjen dhe mirëmbajtjen e shënjave gjeodezike të matjeve.

Zyra Komunale e Kadastrës e kryen punë profesionale dhe shërbime të tjera subjekteve të ndryshme.

Zyra Komunale e Kadastrës mban evidencën për emërimet e vendbanimeve, rrugëve, shesheve si dhe numrat e objekteve dhe të shtëpive.

Zyra Komunale e Kadastrës është përgjegjëse për zhvillim dhe organizimin e kapaciteteve kadastrave, rrjetën referuese homogjene, për sigurimin e hartave Orto-Foto, rikonstruimin e informatave kadastrave në formë digjitale modelin e sistemit informativ mbi tokën dhe pronën.

Vlerësimin e pronës sipas kriterëve dhe standardeve dhe rregulloreve në fuqi.

Sigurimin e zotërimit të tokës, reduktimin e kontesteve për tokën.

Përmirsimin e transferimit të tokës, udheqjen-drejtimin e tokës shtetërore dhe efikasitetin në taksimin e tokave

Planifikimi i rrjetit më pika të reja kontrolluese dhe themelimi i pikave të reja kontrolluese Digjitalizimi i pikave poligonale dhe trigonometrike, vektorizimi i planeve të skanuara (ngastrave dhe zonave kadastrale).

Azhurimi i pjesës grafike në bazë të dokumenteve dhe matjeve të reja dhe transformimi me parametrat të dhëna për transfer.

Shërbimet e mirëmbajtjes së klasifikimit dhe kulturave të tokës.

Ndarja e ngastrave dhe shënimi i kufijve në rastin e eksproprijimit dhe kryen procedurat rreth eksproprijimit të tokës.

inspektimi i sipërfaqës së ndërtesave dhe përpunimi i skicave të ndarjeve për ndërtesa dhe banesa.

Regjistrimi i pronës së palujtëshme dhe regjistrimin e tokës komunale.

Zhvillon procedurat e regjistrimit sipas detyrës zyrtare dhe zhvillon procedurat e regjistrimit sipas kërkesës së palëve.

Bën kontrollimin e regjistrimit sipas procedurave dhe zbaton të gjitha dispozitat pozitive në fuqi lidhur me regjistrimin e pronës.

Azhurimi i pronës në bazë të dokumenteve të verifikuara dhe shënimeve të tjera nga dokumentacioni arkivor, azhurimi i regjistrimit të ndërtesave të mjeteve nga tereni.

Kryen procedurat rreth transaksioneve të pronës shoqërore dhe kryen procedurat e blerjes dhe shitjes së pronës për komunën.

Shqyrton dhe kryen procedurat administrative për kthimin e tokës pronarëve të mëparshëm.

Mbron pronën komunale-shoqërore nga uzurpimet dhe udhëheq procedurat lidhur më këtë çështje.

Bën vërtetimin dhe zbaton shitblerjen e pasurisë së patundshme.

Kryen procedurat rreth dhënës së tokës për ndertim.

Bën regjistrimin e ndërtesave kolektive dhe organizon mirëmbajtjen e pjesëve të përbashkëta të ndërtesave kolektive.

Udhëheq me kadastrën etazhe të banesave dhe udhëheq me banesat dhe objektet të tjera të komunës.

Kryen procedurat për vërtetimin e transaksioneve dhe regjistrimin e tyre në librat etazh.

Përgaditë specifikacione ftesa për tendër për kryerjen e punëve që bëjnë.

Lidh kontrata mbi dhënien me qira të tokës ndërtimore.

Për të funksionuar Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë do të këtë tre sektor :

1. sektori për gjeodezi,
2. sektori për kadastër dhe
- 3 sektori për pronë.

Neni 63

Drejtoria për urbanizëm, dhe mbrojtje të ambientit

Bazuar në ligjin për vetëqeverisjen lokale të komunave të republikës së Kosovës Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit ka drejtorin e emëruar nga kryetari i komunës, i cili/cila ka përgjegjësi për udhëheqjen dhe të drejtuarit e drejtorisë, i raporton kryetarit rregullisht për çështjet që janë në kompetencë të tij apo saj.

a) Planifikimi urban dhe rural

Komuna e Skenderajt duhet ta përgatis planin hapësinor brenda territorit të komunës, në pajtim me ligjin 2003/14 mbi Planifikim Hapësinor Komuna e Skenderajt është përgjegjëse për përgatitjen e Planit Zhvillimor të komunës cili mbulon territorin e brendshëm të saj. Ky plan është një plan strategjik multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe hapësinor. Plani zhvillimor i komunës duhet të përfshijë planin për zhvillim të zonave urbane dhe fshatit brenda komunës.

Sipas nenit 32 të Ligjit 2003/14 (korrigjuar) për Planifikimin Hapësinor, kërkohet që planet e para komunale të përgatiten brenda afatit prej 12 muajve nga dita e pranimit në Kuvendin e Kosovës të planit hapësinor për Kosovën.

Komuna është kompetente për dhënien e lejes për të gjitha ndërtimet, përveç rasteve të regjistruara në nenin 35 të Ligjit për ndërtime. Në rast se ndërtimi prek territorin e dy ose më shumë komunave, komuna ku investuesi ka bërë kërkesën për leje ndërtimi lëshon lejen.

Komuna e cila lëshon lejen duhet të koordinojë veprimet me komunën tjetër.

Duke u bazuar në planin për zhvillim komunal, urban dhe planin rregullues, komunitat do t'i ofrojnë Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal një vlerësim mbi shfrytëzimin e tokës komunale. Sipas këtij vlerësimi do të bëhet identifikimi dhe shfrytëzimi i tokës komunale për qëllime sociale.

Komuna siguron zbatimin e ligjit dhe vendimeve të aplikueshme nga fushëveprimi i Planifikimit Urban.

Organizimi dhe koordinimi në lëmin e planifikimit urban dhe rural.

Përgatitjen dhe hartimin e akteve të përgjithëshme normative të Planifikimit Urban dhe rural.

Bashkëpunon me institucionet e komunës, me rastin e përgatitjes dhe hartimit të planeve hapësinore, urbanistike, planeve të rregullimit dhe planeve tjera.

Planifikimin e zhvillimit hapësinor dhe urbanistik të komunës.

Planin urbanistik, përkatësisht i cakton kushtet për rregullimin e hapësirës.

Bashkëpunon me Kuvendin e Komunës, Komitetin e Planifikimit Urban, Kadastër dhe Mbrojtjen e Mjedisit dhe organet tjera të Kuvendit Komunal, ku do të trajtojnë çështje nga lëmi e planifikimit të hapësirës dhe urbanizmit. merr pjesë aktive në procedurat e

planifikimit të hapësirës dhe rregullimit të tokës ndërtimore, planeve dhe programeve nga kjo lëmi.

Këshillon palët për procedurën dhe mënyrën e realizimit të të drejtave nga lëmi i urbanizmit, kryen edhe detyra tjera nga fushëveprimi i vetë dhe lëmi i rregullimit të hapësirës dhe urbanizmit dhe mbrojtjes së ambientit.

Përpunon kërkesat për lëshimin e lejeve ndërtimore dhe përcakton kushtet urbanistike për zbatimin e planit hapësinor, planit urbanistik, planit të rregullimit, planit të parcelimit, vijës së rregullimit dhe ndërtimit.

Jep shënime mbi madhësinë dhe destinimin e ngastrës së caktuar ndërtimore ose kompleksit të tokës dhe karakteristikat e parshtuara të ndërtimit.

b) Lejet e ndërtimit

Lejet e përdorimit dhe të shfrytëzimit;

Të caktojë komisionet për mbikëqyrje të objekteve;

Pelqimin e rregullimit të infrastrukturës;

Hartimin e planit për vendosjen dhe ndërtimin, si dhe cakton kushtet e objekteve me karakter të përkohshëm në përputhje me ligjin dhe vendimet e aplikueshme dhe mban evidencë e tyre.

Bën përgatitjen dhe hartimin e rregulloreve, projekt-vendimeve, vendimeve propozimeve dhe këshillave profesionale organeve të Kuvendit të Komunës si dhe për Planifikim Urban, Kadastër .

Bashkëpunon me institucionet komunale të administratës dhe sektorin ligjor lidhur me lëndët dhe kontestet gjyqësore.

Ndihmon në përgatitjen e lëndve që i drejton, përgatit lëndët për gjykatë dhe subjekteve tjera të involvuara në zbatimin ligjit dhe dispozitave tjera nga lëmia e urbanizmit dhe rindërtimit. Bënë protokollimin evidencimin, përpunimin, arkivimin e lëndëve që i drejtohen drejtorisë, arkivimin dhe ruajtjen e dokumentacionit teknik dhe investivo – teknik.

Jep shënime mbi madhësinë dhe destinimin e ngastrës së caktuar ndërtimore ose kompleksit të tokës dhe karakteristikat e parshtuara të ndërtimit.

c) Mbrojtjen e Mjedisit

Ligji mbi mrojtjen e mjedisit 2003/1 identifikon autoritetet publike që do të bëjnë implementimin e një apo më shumë dispozitave të këtij ligji, krijimin e autoriteteve specifike dhe detyrimet autoriteteve publike që dalin nga ky ligj. Ky ligj gjithashtu do të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet e personave apo ndërmarrjeve të prekura nga aktivitetet e autoriteteve të tilla publike apo me persona të interesuar për promovimin e mjedisit të shëndeteshëm në Kosovë.

Në pajtim me ligjin 2003/1 mbi Mrojtjen e Mjedisit, komuna do të përgatit plane për mbrojtjen e mjedisit lokal, do të përgatisin standarde për mbrojtësit e mjedisit dhe do të mbrojnë zbatimin e saj; do të krijojnë masa për mbrojtje të natyrës; do të krijojnë dhe fuqizojnë masa për kontrollim të nivelit të zhurmës dhe aktivitete të ngjajshme të përcaktuara me ligj.

Komuna mund të adaptojë programe komunale për mbrojtjen e mjedisit dhe programe pune të ngjashme. Këto programe do të jenë në pajtim me ligjin 2003/1 për Mrojtjen e Mjedisit dhe aktet plotësuese normative të miratuara në bazë të këtij ligji. Planet për mbrojtje të mjedisit hapësinor do të përgatiten në pajtim me ligjin 2004/24 për ujin dhe ligjet relevante.

Në koordinim me shkollat dhe shoqëritë civile, komuna do të ofrojë informata publike dhe publicitet për çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin.

Formimi i politikës vjetore turistike dhe propozimi i masave me të cilat do të nxitet sektori privat për t'i arritur synimet e politikës së zhvillimit të turizmit;

Nxitja e zhvillimit të veprimtarisë turistike për prodhimin e produkteve të reja turistike dhe të produkteve interesante për tregun, por edhe rritja e cilësisë së ofertës turistike në nivel lokal.

Komuna siguron mbështetje në zhvillimin e projekteve në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mjedisit.

Bënë planifikimin hapësinor dhe urbanistik, në marrjen e aktiviteteve lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjatë ndërtimit

në planin urbanistik dhe jashtë tij. Bënë urbanizimin dhe rregullimin e qendrave të bashkësive lokale, bënë përpunimin detal të planeve dhe kontrollimi i objekteve të ndërtuara dhe lëshuarja e lejeve të përdorimit sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mrojtje të Ambientit do të ketë 2 sektor:

1. sektori i urbanizmit,
2. sektori ambientit.

Neni 64

Drejtoria për arsim dhe kulturë

Bazuar në ligjin për vetëqeverisjen lokale të komunave të Republikës së Kosovës, Drejtoria për Arsim dhe Kulturë ka drejtorin e emëruar nga kryetari i komunës, i cili/cila ka përgjegjësi për udhëheqjen dhe të drejtuarit e drejtorisë, i raporton kryetarit rregullisht për çështjet që janë në kompetencë të tij apo të saj.

a) Arsimi

Bazuar në ligjin 2002/2 mbi arsimin fillor dhe të mesëm i cili rregullon çështjet e arsimit fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në shkolla dhe në institucione të aftësimin në Kosovë, me përjashtim të rasteve ku rregullohen në mënyrë të veçantë me 02/-52 për arsimin parashkollor. Bazuar në ligj komuna është përgjegjëse për :

Nxit barazinë në mundësinë për të ndjekur arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm në komunë;

Zhvillimin dhe aftësimin e personelit;

Zhvillimin e të gjitha aspekteve tjera të arsimit lokal;

Respekton dhe nxit të drejtat e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre;

Drejtoria nxit bashkëpunimin në mes të mesimdhënsve, prindërve, nxënësve dhe institucioneve arsimore si dhe midis institucioneve arsimore dhe familjes;

Regjistrimin e të dhënave personale për nxënës, sipas formularit të miratuar nga MASHT dhe në harmoni me ligjin;

Bashkëpunon me MASH-in në planifikim dhe koordinim të arsimit parshkolor, fillor, dhe të mesëm në Kosovë;

Planifikon zhvillimin e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm në komunë, në konsultim me MASHT-in dhe komunat tjera;

Bashkëpunon me drejtoritë tjera të komunave në projekte të përbashkëta arsimore, në përdorimin e përbashkët të burimeve fizike dhe njerzore, si dhe caktimin e fondeve për projekte dhe qëllime të tilla;

Në marrveshje me MASHT-in, miraton rregullat për themelimin, shkrirjen, ndarjen dhe mbylljen e institucioneve arsimore me fonde publike të niveleve 0, 1, 2 dhe 3 në Komunë;

Rregullon së cilat shkolla i përkasin zonave specifike të mbulimit në komunë;

Mirëmbajtjen dhe riparimin e ndërtesave dhe paisjeve të institucioneve arsimore me fonde publike si dhe sigurimin e dispozitave për mirëmbajtje të shërbimeve mbështetëse për mirëqenje fizike të nxënësve, duke përfshirë ujë të freskët, ambiente banjash dhe shërbime shëndetësore;

Marrjen e masave për të siguruar që ambienti rrethues urban apo rural, në të cilin është e vendosur shkolla, është në përputhje me të drejtën e nxënësve për të pasur një mjedis të sigurt në oborrin e shkollës;

Nxitjen e bashkëpunimit me MASHT-in, politikën shoqërore dhe objektivat e shëndetit publik ndërmjet aktiviteteve shkollore dhe jashtëshkollore, duke përfshirë programe për sigurinë në rrugë, fusha, të nxisë shtimin e shëndetit për të shmangur përhapjen e sëmundjeve ngjitëse, si dhe aksione kundër duhanit dhe formave të abuzimit me drogë;

Miratimin e pushimeve të shkollës, në përputhje me ligjin përkatës të arsimit dhe miratimin e rregullave të shkollës. Punësimin dhe pagat e personelit mësimdhënës në institucionet arsimore të komunës;

Merr vendime ndaj ankesave ndaj vendimeve drejtuese të institucioneve arsimore, të parapara me ligj;

Shqyrton vazhdimisht masat e marrura për realizimin e arsimit special, në realizimin e kësaj detyre atë masë që është e nevojshme ose e dëshirueshme, drejtorja konsultohet me MASHT-in dhe drejtorit komunale tjera për koordinimin e arsimit të fëmijëve që kanë nevojë për arsim special;

Bënë vlersime të nevojave speciale, siç përcaktohet me ligj;

Miraton rregulloret për sjelljen dhe disiplinën e nxënësve në çdo institucion arsimor, pasi të këtë marr më parë propozimet e këshillit të shkollës dhe komentet e drejtorit për këto rregullore;

Propozimin për arsimin special për nxënës dhe dhënia e vlersimit profesional;

Propozimi për themelimin e shërbimit këshillimor dhe shëndetësor për nevoja speciale;

Pjesëmarrje në përzgjedhjen e drejtorëve dhe mësuesëve që punësohen në shkollat e komunës;

b) Kulturë

Bazuar në nenin 10 të ligjit 02/L-75 për institucionet e kulturës, organi kompetent i komunës, institucionit, mundë t'ia bartë kompetencat e veprimtarisë për të cilën është themeluar.

Bazuar në nenin 12.2 institucioni publik i kulturës themelohet nga Kuvendi i Komunës, me vendim.

Bazuar në nenin 12.3 për institucionet e kulturës thuhet se po qe se institucionin e themelojnë dy apo me shumë komuna, aktin mbi themelimin e nxjerrin komunat e interesuara në formë të marrveshjes me të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella në pajtim me ligjin.

Brenda ligjeve aplikative që e rregullojnë sektorin, komunat do ti menaxhojnë resurset lokale kulturore duke përfshirë muzet lokale dhe resurset e trashëgimisë kulturore.

Komuna do ti rregullojë kinematë publike dhe xhirimet kinomatografike në territorin e saj në pajtueshmëri me ligjin 2004/22 të Kuvendit të Kosovës mbi kinematografinë.

Komuna do ti rregullojë dhe do t'i mirëmbajë arkivat konform ligjit të Kuvendit të Kosovës 2003/7 mbi lëndën arkivore dhe arkivin.

Komuna do të themelojë dhe do të operojë me bibliotekat publike brenda territorit të saj

Në pajtueshmëri me Ligjin e Kuvendit të Kosovës 2003/6 mbi bibliotekat.

Komuna do t'i mbështes aktivitetet teatrale brenda territorit të saj në pajtueshmëri me Ligjin e Kuvendit të Kosovës 02/L-12 që rregullon funksionimin e veprimtarisë teatrore.

Qendra e artit dhe të kulturës të themeluara në pajtueshmëri me Kaptinën 8 të Ligjit të Kuvendit të Kosovës 02/L-12 do të udhëheqet nga komuna në të cilën gjindet.

Për çdo vit komuna do ta bëjë publike shumën e buxhetit të disponueshëm në territorin e saj për përgatitjen e aktiviteteve kulturore duke përfshirë paratë e granteve që janë në dispozicion të personave të kualifikuar dhe t'i vendosin rregulloret për dorëzimin e aplikacioneve të granteve dhe dhurimit të granteve.

Të udhëheq në mënyrë të drejtë me tatër, bibliotekë, arkiv, stadiumin e qytetit, palestrën e sporteve.

Të kujdeset edhe për formacione të tjera nga kultura, rinia, e sporti që nuk kanë hapësirë e kushte pune.

Të organizojë dhe shenojë data me rëndësi historike kur kërkohet;

Të organizojë debate për zhvillim dhe avancim të kulturës;

Të rishqyrtojë raporte kontraktuese në lidhje me objektet e kulturës;

Të grumbullojë shënime faktike për të arriturat në kulturë,

Të bashkëpunojë ngushtë dhe të raportojë për punën e vet Kryetarit të Komunës Komitetit për Arësim, Kulturë, Rini dhe Sport kurdo që këkohet;

Të bashkëpunojë me drejtorin në nivel qendror nga fushë veprimtaria e kulturore këshilltarët nga këto fushë veprimtari .

Të bëjë regjistrimin e grupeve, klubeve, kuvendeve etj;

c) Sport

Komuna është organ kompetent për udhëheqjen e qendrave publike sportive në territorin komunal në pajtueshmëri me nenin 58 të ligjit të Kuvedit të Kosovës 2003/24 mbi Sportin.

Komuna do të zhvillojë një plan, në koordinim me Ministrinë e Rinisë, Kulturës dhe Sporteve, për të vendosur qendra të përshtatshme publike sportive në territorin e tyre në pajtueshmëri me nenin 11 të ligjit 2003/24 mbi Sportin, planet e tilla duhet të përfshijnë përgaditjen e sallave të mbyllura sportive.

Në pajtueshmëri me ligjin, komuna është përgjegjëse për t'i ndihmuar dhe mbështetur aktivitetet sportive, si dhe për të zhvilluar (promovuar) sportin brenda territorit të vet.

Në çdo vit komuna do të bëjë publik buxhetin e saj komunal për të siguruar

Aktivitetet kulturore duke përfshirë grante për persona relevant si dhe do të përpilojë Rregullore për dorëzimin e aplikacioneve për grante dhe caktimin e granteve.

Të bashkëpunojë ngushtë dhe të raportojë për punën e vet Kryetari të Komunës dhe komitetit për arsim, kulturë dhe sport kurdo që këkohet ;

Të grumbullojë shënime faktike mbi të arriturat në Sport.

d) Rini

Të grumbullojë shënime faktike mbi të arriturat në çështjet Rinore

Të bashkëpunojë ngushtë dhe raportoi për punën e vet Kryetarit të Komunës Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport kurdo që kërkohet;

Të bashkëpunojë me drejtorinë në nivel qendror nga nga fushë veprimtaria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;

dhe këmbim përvojash si dhe me OJQ e organizata tjera;

të respektojë, të përkrah dhe të ndihmojë asociacione, klube, shoqata, dhe të krijojë individ me aftësi të posaçme kreative pa bërë ndonjë dallim, racor, gjinor, religjioz nacional ;

të ofrojë institucionet e veta në shërbim të përgjithshëm të qytetarëve (me veprimtaritë primare që kryejnë ato, por në raste emergjente dhe veprimtari të tjera);

të joshë investitorët, të kërkojë fonde shtesë;

të organizojë debate për avancim dhe zhvillim të sportit;

të rishqyrtojë raportet kontaktuese në lidhje me objektet e sportit;

të kujdeset edhe për formacione të tjera nga, rinia e sporti që nuk kanë hapësirë e kushte pune;

të bashkëpunojë me arsimin në lidhje me reformat dhe kushtet që mund të kenë të rinjtë;

të krijojë kushte për kthimin e rinisë në vend dhe rieduktimin e tyre;

Të organizojë anketa, seminare e trajnime, kyçje të të rinjëve kosovar në aktualitet rinore, evropiane e botërore;

për të funksionuar Drejtoria për Arsim dhe Kulturë, do të këtë tre

(3) sektor :

1. sektori për arsim

2. sektori për kulturë dhe
3. sektori për rini dhe sport

Neni 65

Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenje sociale

Bazuar në ligjin për vetëqeverisjen lokale të komunave të Republikës së Kosovës , Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale ka drejtorin e emëruar nga kryetari i komunës , i cili ka përgjegjësi për udhëheqjen dhe të drejtuarit e drejtorisë, i raporton kryetarit të komunës rregullisht për çështjet që janë në kompetencën e tij apo saj . përgjegjësitë e drejtorisë, bazuar në Rregulloret dhe aktet tjera ligjore nga lëmi i shëndetësisë primare dhe mirëqenës sociale janë;

a) Shëndetësi primare

Bazuar në ligjin 2004/4 për shëndetësinë komunat sigurojnë zbatimin e kujdesit parësor shëndetësor. Komuna duhet ti jap përparsi masave parandaluese nëpërmjet konceptit të mjekësisë familjare. Nëse zbatimi nga komuna nuk i pëmbush standardet e përcaktuara atëherë mund të ndërhyj Ministria e Shëndetësisë.

Kujdesi parësor shëndetësor përfshinë: promovimin, parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin e sëmundjeve , çrregullimeve dhe lëndimeve; edukimin shëndetësor, imunizimin, diagnostifikimin e parë dhe kujdesin themelor shëndetësor përfshirë dhe ndërhyrje kirurgjike të vogla; promovimin e shëndetit oral dhe kujdesit themelor stomatologjik; kujdesin shëndetësor mendor të bazuar në bashkësi; rehabilitimin të bazuar në bashkësi; ofrimi i ushqimit dhe ujit cilësor.

Komuna në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë do të asistojë me publikun e informata për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në përkujdesin shëndetësor në harmoni me Ligjin 2004/38 për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor të Kuvendit të Kosovës. Komuna do ta nominojë një anëtar të trajnuar të stafit për ti pranuar lutjet e qytetarëve lidhur me trajtimin e tyre në përkujdesjen primare shëndetësore.

Do të licencohen në pajtueshmëri me Ligjin 2003/26 për produktet medicinale dhe paisjet medicinale të Kuvendit Republikës së Kosovës.

Komuna e ka të drejtën e inspektimit të qendrave private të përkujdesjes primare shëndetësore në pajtueshmëri me Ligjin 2004/50 për veprimtarinë private në shëndetësi të Kuvendit të Kosovës.

Komuna do të vedos stafin në qendrat e përkujdesjes primare shëndetësore për brenda parametrave financiare të caktuara nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe pas pranimit të këshillave dhe udhëzimeve nga Ministria e Shëndetësisë për profilin e duhur.

Komuna do të sigurojë konsume farmaceutike dhe mjekësore për qendrat e përkujdesjes primare shëndetësore siç kërkohet nga natyra e veprimeve të tyre dhe në pajtueshmëri me listat e miratuar të blerjes nga resurset e granteve të alokuara në komunë.

Përgjegjësitë e Drejtoirisë në lëmin e shëndetësisë janë:

Vlërsimi i nevojave lokale

Vendosja e objekteve lokale për KPSH

Të zhvillojë buxhetin bazuar në nevojat lokale duke u përmbajtur udhëzimeve nga Ministria e Shëndetësisë

Aprovoi buxhetin dhe implementoi buxhetin vendos dhe mbledh bashkë pagesat brenda kornizës së caktuar nga MSH

Siguron ofrimin e shërbimeve shëndetësore

Raporton mbi të arriturat e objektivave të përcaktuara të Kuvendit Komunal përmes autoriteteve Shëndetësore të Qarkut

Mbikëqyrë situatën epidemiologjike në nivel komunal.

Implementon normat dhe standardet e infrastrukturës, burimeve njëzore të aprovuar nga MSH;

mbledh dhe analizon informatat në nivel lokal;

Shërbehet me informtat për të përcaktuar prioritet lokale dhe objektivat konform strategjisë së kujdesit primar shëndetësor;

shërbehet me të dhena në nivelin e qarkut dhe të Kosovës për të analizuar kualitetin e

shërbimeve dhe përdorim efektiv të burimeve;
masat mbrojtëse shëndetësore që kanë të bëjnë me:

- a) sigurimin e ujit të sigurt dhe higjienës;
- b) sigurimin e ushqimit të sigurt dhe nutriconit (ushqyeshmerisë) ;
- c) aktivitetet e dezinfektimit, deratizimit (çfarosjen e minjve, rriqrave).

Koordinon dhe mbikëqyrë punën e QKMF, QMF dhe ambulancave;
Zhvillimi, monitorimi dhe zbatimi i rregulloreve ekzistuese që lëshon Departamenti i Shëndetësisë të MSH dhe çështjes sociale MPMS;
Ndërmerr fushat senzibilizuese me Organizatat Qeveritare dhe jo Qeveritare dhe harton marrëveshje me to;
Raporton për ofrim të shërbimeve dhe të arriturat komunale në këtë lëmi;
Merret me sisteme informative (menaxhuese dhe epidemiologjike);

b) Mirëqenja sociale

Në pajtueshmëri me ligjin e Kuvendit të Kosovës 02/L017 mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare, komuna do ta operojë Qendrën për Punë Sociale dhe t'i përmbush të drejtat dhe përgjegjësitë që i janë besuar.

Komuna mund t'i vendos dhe të operojë me qendrat për mirëqenje sociale duke përfshirë jetimore, shtëpitë për nëna të vetmuara si dhe për të moshuarit dhe të personave me aftësi të kufizuara, strehim për të pastrehet si dhe qendrat për përkujdesje ndaj fëmijëve.

Qendra për Punë Sociale do të veprojë me skemën për asistencë sociale që është në pajtueshmëri me Ligjin e Kuvendit të Kosovës 2003/15 për skemat sociale.

Komuna në pajtueshmëri me udhëzimin administrativ të lëshuar nga MAPL 2006/06 do të mund të zhvillojë një plan strehim në territorin e vet;
komuna ka të drejtën për të pasur, zhvilluar dhe për të përdorur pronën me qëllim të sigurimit të strehimit social të personave brenda komunës. Komuna mund t'i dërgojë

nivelet e qirasë dhe ti vendosi nivelet e lirit nga pagesa e qirasë.

Komuna ka të drejtë që t'i vendosë l; lirimet për shërbime ndaj qytetarëve nëse

Skemat janë bazuar mbi kriteret e objektivitetit të hapur ndaj publikut dhe në pjtueshmëri

Me ligjin aplikativ.

Komuna është përgjegjëse për sigurimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit sipas standardit të specifikuar nga Ministria.

Sektori për Përkujdesje Sociale i komunës kryen shërbime sociale dhe familjare brenda territorit të vet përmes aktiviteteve të qëndroës për punë sociale ose duke siguruar financim apo ndonjë ndihmë tjetër materiale për organizatat joqeveritare që mrren me këtë veprimtari;

Sektori për Përkujdesje merr hapa për të identifikuar natyrën dhe përmasat e nevojës për shërbime sociale dhe familjare brenda territorit të saj. Komuna përgatit plane vjetore për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve sociale dhe familjare dhe mbanë shënime e statistika;

bashëkpunon me QPS në Komunë, rreth përkujdesjes së rasteve sociale të popullatës së komunës- banimin kolektiv.

Për të funksionuar Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, duhet të këtë dy sektor, e ata janë:

1. sektori për shëndetësi
2. sektori për përkujdesje sociale

Neni 66

Drejtoria për shërbime publike

Bazuar në ligjin për vetëqeverisjen lokale të komunave të Republikës së Koasovës:

- a) Përcakton që ofrimin e shërbimeve publike dhe të infrastrukturës duke përfshirë furnizimin më ujë, ujësjellsin dhe kanalizimin, përpunimin e ujërave të zeza, mirë mbajtjen e rrugëve lokale, transportin lokal dhe planet për ngrohtoret lokale;
- b) Shërbimet publike duke përfshirë shërbimin e zjarrëfikësve dhe të emergjencës.
- c) Sigurimin dhe mirëmbajtjen e parqeve publike , hapësirave të hapura dhe

varrezave ;

d) Lëshimin e lejeve për shërbime dhe pajisje, duke përfshirë transportin lokal publik dhe shërbimin e taksistëve;

a)Transporti lokal

Komuna është përgjegjëse për transportin lokal brenda territorit të vet në pajtim me ligjin 2004/1 mbi transportin rrugor, si dhe do të ushtrojë pushtetin e vet dhe përgjegjësitë në pajtim me këtë ligj.

Komuna do të konsultohet për çështjen e licencimit nga niveli qendror për transportin ndërurban brenda territorit komunal si dhe për lëshimin dhe modifikimin e lejeve për stacione të autobusëve brenda territorit të tyre.

DSHP-ja koordinon aktivitetin mbi transportin publik të mallrave dhe udhëtarëve, me kompanitë publike dhe shoqatat e taksistëve – taksistët individual.

Cakton linjat për bartjen e udhëtarëve në trafikun urban, autobuset.

DSHP-ja jep pëlqimin për regjistrim të veprimtarisë së taksistëve sipas rregullor[es së komunikacionit.

Bën shpalljen e ankandeve publike për automjetet e konfiskuara të cilat nuk tërhiqen në afatin e caktuar nga pronarët

DSHP-ja bashkëpunon dhe koordinon punën me SHPK-në dega në komunë, ku përfshinë këto aktivitete të punës;

Bashkëpunon me policinë e trafikut urban ndër-urban në lirimimin e trotuareve nga automjetet.

Cakton rrugët për të gjitha llojet dhe për automjetet (taksi, autobus, parkingje të limituara dhe të përcaktuara).

Bën shënjëzimin vertikal dhe horizontal të rrugëve;

Mbylljen e rrugëve në rast nevojë (gjatë festave shtetërore dhe në raste tjera të arsyeshme).

b) Furnizimin me ujë, ujësjellsin dhe kanalizimin, përpraimin e ujërave të zeza

Komuna do t'i rregullon shërbimet e ujit sipas marrëveshjes mbi shërbimet e caktuara në rregulloren e UNMIK-ut 2004/49.

Komuna ka të drejtë të caktojë mbledhje shtesë të komitetit konsultativ të konsumatorëve në pajtim me nenin 17 të rregullores së UNMIK-ut 2004/49 në menyrë që të zgjedhen vështësitë apo konfliktet eventuale që kanë të bëjnë me ujin dhe shërbimet publike.

Mbikëqyrë dhe bashkëpunon me kompanitë shërbyese komunale të higjenës dhe furnizimit me ujë.

Në bashkëpunim me kompanitë cakton çmimet e shërbimeve komunale.

Mbikëqyrë mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues dhe ujësjellësit.

Cakton prioritet për mirëmbajtjen dhe zgjerimin e rrjetit ekzistues.

Kontrollion buxhetin e ndërmarrjes.

Bën hulumtimin e burimeve të reja dhe gjetjen e donatorëve për pjesëmarrje në tendër

Në bashkëpunim me kompanitë që ofrojnë shërbimet; propozon buxhetin dhe çmimet e shërbimeve, çmimet e ujit, çmimin e kyçjeve të reja,

Bënë vlersimin dhe lëshimin e lejeve për kyqje të reja,

Cakton orarin e reduktimeve dhe prioritetet,

Bënë sigurimin e ujit nëpër pjesët të cilat nuk kanë mundësi të sigurojnë ujë të pijshëm nga rrjeti, përmes rezervarëve.

DSHP-ja kujdeset për sigurimin e kushteve për pastrimin e ujërave të zeza, dhe nyjet sanitare publike

Kërkon donator për pastrimin e ujërave të zeza

c) Menagjimi i mbeturinave

Bazuar në nenin 55 të Ligjit Nr.02/L-30 për mbeturinat komunale janë të detyruara që në afat prej 18 muajsh t'i harmonizojnë rregulloret e tyre, në bazë të këtij ligji.

Planet lokale për administrimin e mbeturinave nxjerren me qëllim të administrimit të mbeturinave. Planet hartohen nga autoritetet lokale, në pajtim me Planin Strategjik nga

neni 8 i ligjit nr.02/L – 30 mbi mbeturinat. Bazuar në ligjin mbi mbeturimat nr.02/L-30 15.1.

Komuna ka për detyrë :

- a) të hartojë planin lokal për administrimin e mbeturinave;
- b) të hartojë raport vjetor mbi administrimin e mbeturinave të cilat i dorzonë në Ministri, në tremujorin e parë të vitit vijues;
- c) të rregullojë, zbatojë dhe organizojë administrimin e mbeturinave komunale në territorin e sajë;
- d) të merr pjesë në lëshimin e vendimeve për ndërtimin e objekteve, për trajtimin e mbeturinave;
- e) të kryejë punë tjera, të përshkruara me këtë ligj si dhe aktet tjera, për administrim të mbeturinave;
- f) të caktojë tarifa për shërbimet e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave komunale nga ndërmarrjet për administrimin e mbeturinave.

Neni 52.2 i ligjit mbi mbeturinat dy apo më shumë komuna, për ineteresin e tyre, mund të bëjnë marrëveshje për administrimin e mbeturinave në territorin e tyre.

DPSH-ja kujdeset për mbledhjen e mbeturinave duke kryer këto aktivitete të punës :

Aprovon orarin dhe kohën e propozuar për bartjen e mbeturinave

shqyrton mundësinë e futjes në sistemin e bartjes së mbeturinave edhe të fshatrave
organizon aksione të pastërtisë

bartjen, deponimin dhe përpunimin e hedhurinave, mirëmbajtjen e varrezave;

Përcjell procedurën e pastrimit të ujërave, sipërfaqeve publike;

Menaxhimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha shesheve që i përkasin komunës

Drejtoria për Shërbime Publike kujdeset për mirëmbajtjen, kontrollin inspektimin e tregut të gjelbër dhe të kafshëve

d) Vendet publike

Komuna do të miratojë rregullorën për menagjimin dhe mbrojtjen e vendeve publike në territorin e saj dhe në pajtim me ligjet e aplikueshme si Rregullorja 2003/30 mbi Planifikimin hapësinor dhe rregullorja 2003/9 mbi mbrojtjen e mjedisit.

Sipas ligjit vendet publike përfshijnë : parkingjet, rrugët dhe trotuaret, vendet për parkim, tregu, lagjet, varrezat, vendet publike për pushim, parkingjet, memorialet, fushat për lojë, fushat sportive, pishinat publike, lumenjet dhe deget e tyre, ujëvarat, shpellat, monumentet historike dhe kulturore, vendet e gjelbruara, vend parkimet dhe hapësirat para ndërtesave, stacionet dhe tunelet publike.

Komuna është përgjegjëse për emërimin e vendeve publike, pas konsultimit me popullin dhe në pajtim me ligjin 2004/2 mbi Gjininë.

Komuna do të punojë me qytetarët, policinë dhe me autoritetet tjera për të implementuar projekte dhe kontrole me anë të së cilave ofrohet siguri për fëmijët në vendet publike.

Komuna duhet ta rikthejë gjelbrimin në vendet publike si dhe të krijojë parkingje të reja, vende të gjelbruara dhe vende të ngjajshme publike.

Menaxhimi i vendeve publike në hapësirat urbane do të behët në përputhshmëri me Kartën Evropjane për Urbanizëm, dhe sipas burimeve të disponueshme do të kërkohet implementimi i parimeve të kësaj karte.

Përgjegjës për dhënjen e lejeve për shfrytëzimin e hapësirave publike para lokaleve dhe të lokacioneve për shitjen e librave, vendosjen e lojërave për fëmijë dhe vendosjen e objekteve lëvizëse;

Përgjegjës për ndriçimin publik, tabelat reklamuese, reklamat ndriçuse të firmave dhe reklamave.

Merr pjesë në komisionin për pranimin teknik të punëve të kryera – ndriçimi publik, mirëmbajtja e rrjetit publik

Bënë kontrollimin e trotuareve

Menaxhimin dhe kontrollimin e të gjitha shesheve që i përkasin komunës.

e) Rrugët lokale

Komuna ka autoritet lokal për rrugë dhe për implementimin e ligjit 2003/11 mbi rrugët si dhe të ushtrojë pushtetin e vet dhe përgjegjësinë në pajtim me këtë ligj.

Komuna do të ofrojë raporte vjetore MAPL-së për gjatësinë, llojin dhe kushtet e rrugëve lokale në pajtim me kushtet e përcaktuara sipas udhëzimit administrativ.

Komuna do të konsultohet nga niveli qendror për ndërtimin riparimin e shenjave apo ndryshimin e rrugëve ndër-komunale që ndikojnë në komuna tjera. Komuna do ta informojë MTTK për defektet në rrugë në territorin e saj.

Kujdeset për mirëmbajtjen e rrugëve në komunë,

Renovimin e rrugëve të asfaltuara,

Mbushjen e gropave më zhavorr,

Zgjerimin e rrugëve nëpër fshatra,

DSHP-ja në sezonin e dimrit bënë kryposjen dhe pastrimin e rrugëve dhe shesheve që i përkasin komunës.

Është kompetente për lëshimin e lejeve që i përkasin komunës për vendosjen e pengesave

f) Shërbimi i zjarrfikësve dhe të emergjencës

Bazuar në ligjin nr.02/68 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera neni 31 kompetencat e komunës neni 31.1 përshkruan kompetencat e komunës në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera.

Bazuar në nenin 31.2 të këtij ligji komuna, gjatë realizimit të detyrave të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera bashkëpunon ndërmjet vetës dhe mund t'i bashkojnë mjetet dhe shërbimet për realizimin e çështjeve të përbashkëta në mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera.

Bazuar në ligjin Nr.02/L-41 për mbrojtje nga zjarri neni 5 mbi përgjegjësitë e komunave:

Komuna në territorin e saj e organizon mbrojtjen nga zjarri, kujdeset për zbatimin dhe përparimin e masave të mbrojtjes nga zjarri.

Kuvendi i Komunës nxjerr planin e mbrojtjes nga zjarri në mbështetje të vlerësimit të rrezikut nga zjarri në pajtim me udhëzimet e lëshuara nga Ministria.

Kuvendi i Komunës me qëllim të përcjelljes dhe të zbatimit të planit të mbrojtjes nga zjarri, së paku një herë në vit e shqyrton përmbajtjen e tij, të vlerësojë përputhshmërinë e këtij plani me planin e ri urbanistik, me ndryshimet ndërtimore dhe të ngjajshme. Ajo, gjithashtu, përcjell realizimin financiar të mjeteve të parapara për mbrojtje nga zjarri.

Komunë organizon punën e shërbimit të oxhaktarëve si dhe kryen mbikëqyrjen e punës të shërbimit të oxhaktarëve.

Neni 28 përkatësisht 28.3 theksohet që dy apo më shumë komuna, ndërmarrje industriale mund të themelojnë njësinë e zjarrfikës të përbashkët të aftë për intervenim, nëse konfiguracioni gjeografik e mundëson një gjë të tillë.

Bazuar ne ligjin Nr.02/L41 për mbrojtje nga zjarri neni 31,32,33,34, dhe 35 theksohet që:

Stacionet e zjarrfikjes dhe shpëtimit i udhëheq eprori, i cili duhet të këtë përgatitjen adekuate dhe i cili është i aftësuar profesionalisht për të udhëhequr me stacionin zjarrfikës.

Në stacionin e zjarrfikjes dhe shpëtimit mund të pranohet në punë personi, i cili përveç kushteve të përgjithshme duhet të këtë të kryer më së paku shkollën e mesme dhe të mos jetë më i vjetër së 35 vjet, dhe në pikpamje psiko-fizike i aftë për kryerje të punëve në këtë shërbim, aftësinë psiko-fizike e vërteton komisioni i posaçëm i institucionit përkatës.

Në kryerjen e punëve nga lëmi i zjarrfikjes dhe shpëtimit nuk mund të angazhohet personi që nuk është i aftësuar nga ana profesionale për shuarje të zjarrit dhe për shpëtim.

Stacioneve të zjarrfikjes dhe shpëtimit ndihmë profesionale iu ofron Departamenti, jep udhëzime profesionale dhe kryen mbikëqyrjen mbi punën e këtyre shërbimeve.

Njësitë e shërbimit të zjarrfikjes dhe shpëtimit kanë për detyrë të mbajnë evidencën e përcaktuar dhe të informojnë Drejtorinë mbi kryerjen e detyrave nga fushëveprimi i vet.

Punëtoret e njesisë së shërbimit të zjarrfikjes dhe shpëtimit kanë uniformën e tyre të njëjtë në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Gjatë shuarjes së zjarrit dhe shpëtimit të njërzve dhe pasurisë së tyre punëtoret duhet të jenë të pajisur me mjete mbrojtëse të parapara me udhëzim administrativ.

Bazuar në ligjin Nr.02/L-41 për mbrojtjen nga zjarri neni 58 Komuna është e obliguar ta harmonizojë planin e mbrojtjes nga zjarri, neni 5 paragrafi 5.2 në bazë të dispozitave të këtij ligji në afatin prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi.

Personat juridik dhe shërbimet profesionale janë të obliguara të harmonizojnë rregulloret për mbrojtje nga zjarri (neni 9) me dispozitat e këtij ligji në afatin kohor 6 muaj nga dita e hyrjes në fuqi në zbatueshmëri me dispozitat nga neni 9.2 të këtij ligji.

Organizata e autorizuar nga neni 20 paragrafi 20.1 dhe 20.2 neni 21 paragrafi 21.3 dhe neni 22 paragrafi 22.5 të këtij ligji janë të obliguara që në afatin prej 6 muajve, nga dita e nxjerrjes të udhëzimeve administrative, të cilat rregullojnë kushtet për kryerjen e punëve të inspektimit, të harmonizojnë veprimtarinë e tyre me dispozitat e atyre udhëzimeve.

Ka për detyrë që të organizojë punën me organet e sigurisë në Komunë, në bashkëpunim me KFORI-in, UNMIK-un, SHPK-në dhe TMK-në.

Në sferën e emregjencës bashkëpunon me : organizatat joqeveritare-institucionet shëndetësore , lokalitetet urbane dhe rurale në rastet e fatkeqësive elementare, zjarreve, vërshimeve, tërmeteve si dhe në rastet tjera ku parqitet nevoja.;

Bënë vlersimin e shkallës së rrezikshmërisë në komunë dhe njëkohsisht ndërmerr masat preventive për parandalimin dhe evitimin e rrezikshmerisë.

Në rastet e jashtëzakonshme i propozon kryetarit të komunës për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme si dhe propozon urdhëresa dhe masa tjera administrative në rastet e gjedjes së veshtirë nga kushtet klimatike me qëllim të tejkalimit të situatës.

Bashkëpunon me shërbimin e zjarrfikësve dhe zyrën për prandalimin e zjarrit.

Bënë dokumentacionin përkatës për paisjen e qytetarëve me lejet për armë sportive dhe mban evidencën në lidhje me dokumentacionin përkatës;

Mbikqyrë objektet e KK-së dhe njëherit bëjnë angazhimin e personelit për sigurim të objekteve;

Për të funksionuar Drejtoria për Shërbime Publike Komunale; do të këtë katër (4) sektor:

1. Sektori i shërbime publike,
2. Sektori i inspektionit,
3. Sektori i mbrojtjes dhe shpëtimit dhe
4. Sektori i shërbimeve teknike.

PJESA E XIV – DEMOKRACIA E DREJTËPËRDREJTË DHE MEKANIZMAT E PJESËMARRJES SË QYTETARËVE

Neni 67

Informimi publik dhe konsultimi

67.1 Çdo komunë mban periodikisht, së paku dy herë në vit mbledhje publike në të cilat mund të marrë pjesë së i cili person apo organizatë me interes në komunë.

Data dhe vendi i mbledhjes caktohet së paku dy javë përpara. Njëra nga mbledhjet mbahet gjatë gjashtë muajve të parë të vitit.

67.2 Në këto mbledhje përfaqësuesit komunal informojnë pjesëmarrësit për aktivitetet e komunës, kurse pjesëmarrësit mund të shtrojnë pyetje dhe të japin propozime për përfaqësuesit e zgjedhur komunal.

67.3 Përveç mbledhjeve publike të cekura më lartë , komuna është e obliguar t'i informojë qytetarët e komunës për çfarëdo planesh apo programesh të rëndësishme me interes publik, siç rregullohet me statutin e komunës.

67.4 Kuvendi i komunës miraton rregulloren komunale që promovon (krijon) transparencë të organeve legjislative , ekzekutive dhe administrative të komunës, duke e rritur pjesëmarrjen e publikut në marrjen e vendimeve në nivel lokal dhe duke lehtësuar qasjen publike në dokumentet e komunës. Ministria përgjegjëse për qeverisje lokale mund të nxjerrë udhëzime administrative për transparencë komunale.

67.5 Çdo person mund të kontrollojë çfarëdo dokumenti që mbahet nga komuna, përveç nëse zbulimi i tillë nuk është i ndaluar sipas ligjit për qasjen në dokumentet zyrtare.

Neni 68

E drejta e peticionit

68.1 Çdo person apo organizatë me interes për komunën ka të drejtën e prezantimit të peticionit në kuvendin e komunës për çfarëdo çështje lidhur me përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës.

68.2 Kuvendi i komunës shqyrton peticionin në pajtim me statutin dhe rregulloren e punës.

Neni 69

Iniciativa e qytetarëve

69.1 Qytetarët mund të marrin iniciativë për të propozuar rregullore , brenda kompetencave të komunës , për miratim nga kuvendi apo me votën e qytetarëve, në pajtim me ligjin në zbatim.

69.2 Propozuesit ia dorëzojnë projektin e rregullores së propozuar kryesuesit të kuvendit të komunës.

69.3 projekt rregullorja e propozuar duhet të nënshkruhet nga 15% e votuesëve për t'u shqyrtur nga kuvendi i komunës.

69.4 Kuvendi i komunës është i obliguar ta shqyrtojë rregulloren e propozuar brenda 60 ditësh pas pranimit.

Neni 70 Referendumi

70.1 Qytetarët e komunës mund të kërkojnë që rregullorja e kuvendit të komunës, e miratuar nga kuvendi i komunës , t'i nënshtrohet referendumit.

70.2 Kërkesa duhet t'i dorëzohet kryesuesit të kuvendit të komunës , brenda 30 ditësh nga data e miratimit të rregullores, e cila duhet të nënshkruhet nga 10% e votuesëve të regjistruar.

70.3 Kuvendi i komunës duhet ta shqyrtojë kërkesën brenda 30 ditësh pas pranimit të petitionit , sipas ligjit në fuqi.

Neni 71 Largimi i kryetarit

71.1 Qytetarët e komunës mund të ndërmarrin iniciativë për largimin e kryetarit të komunës.

71.2 Kërkesa e tillë duhet të nënshkruhet nga njëzetë (20) përqind e votuesëve të regjistruar dhe i dorëzohet kryesuesit të kuvendit të komunës , i cili e paraqet çështjen në institucionin përkatës për administrimin e votimit.

71.3 Nëse shumica e votuesëve të regjistruar votojnë për largimin e kryetarit , zgjedhjet e reja duhet të bëhen në pajtim me ligjin për zgjedhjet.

Neni 72
Komitetet konsultative

71.1 Kuvendi i komunës themelon komitete këshillëdhënëse sektoriale me qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

72.2 Anëtarësia e komiteteve përbëhet nga qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare.

72.3 Komitetet konsultative mund të dorëzojnë propozime, bëjnë hulumtime dhe ofrojnë mendime për iniciativat e kuvendit të komunës.

PJESA E XV – MARDHËNJET NDËRMJET QEVERISË QENDRORE DHE LOKALE

Neni 73
Objektivat e shqyrtimit Administrativ

73.1 Shqyrtimi administrativ i komunës ka objektivat vijuese:

- a) të forcojë aftësinë e organeve të vetëqeverisje ndihmëse;
- b) të sigurojë ligjshmëri të vetëqeverisjes lokale; dhe
- c) të sigurojë që të drejtat dhe interesat e qytetrëve të respektohen.

Neni 74
Anëkesat e qytetarëve

Anëkesat e qytetarëve kundër një akti administrativ të komunës shqyrtohen sipas ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.

PJESA E XVI – DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 75

Me hyrjen në fuqi të këtij statuti , shfuqizohet statuti nr.110-145 i datës

12.06 .2008.

Neni 76

Nga dita e hyrjes në fuqi e këtij statuti , në një afat prej gjashtë (6) muajve duhet të harmonizohen të gjitha rregulloret komunale dhe aktet tjera nënligjore.

Neni 77

Sa herë që dispozitat e këtij statuti, janë në kundërshtim me ligjin , atëherë do të zbatohen dispozitat e ligjit.

Neni 78

Ky statut hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Skenderajt.

NR. _____

Skenderaj, më _____

KUVENDI I KOMUNËS

K r y e s u e s i

Ismet Salihu